



**DIREKTIVA E BE-SË MBI NDIHMËN JURIDIKE PËR TË  
DYSHUARIT DHE PERSONAT E AKUZUAR NË PROCEDURËN  
PENALE DHE PËR PERSONAT E KËRKUAR NË PROCEDURAT E  
URDHËRARRESTIT EVROPIAN**

**MANUAL I TRANSPOZIMIT**



## **Rreth “FairTrials”**

“FairTrials” është një organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me zyre në Londër, Bruksel dhe Uashington, D.C., e cila është e fokusuar në përmirësimin e të drejtës për gjykim të drejtë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Puna jonë bazohet në besimin se gjykimet e drejta janë një nga gurthemet për një shoqëri të mirëfilltë: kjo parandalon rrënimin e jetës nga gabimet e drejtësisë dhe e bënë shoqërinë më të sigurt duke kontribuar në sistemin transparent dhe të besueshëm të drejtësisë për të ruajtur besimin e publikut. Megjithëse në parim njihet si një e drejtë universale, në praktikë e drejta themelore e njeriut për gjykim të drejtë abuzohet në mënyrë rutinore. Puna e “FairTrials” bënë një kombinim mes: (a) ndihmës dhënë të dyshuarve që të kuptojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre; (b) ndërtimin e një rrjeti të mbrojtësve të gjykimit të drejtë të angazhuar dhe të informuar (përfshirë OJQ-të, avokatët dhe akademikët); dhe (c) luftimin e shkaqeve themelore të gjyqimeve të padrejta nëpërmjet hulumtimit, procesit gjyqësor, avokimit politik dhe fushatave.

## **Rreth Panelit Këshillëdhënës të Ekspertëve Ligjorë**

Paneli Këshillëdhënës i Ekspertëve Ligjorë (ose LEAP) është një rrjet ekspertësh ndërkombëtarë në drejtësinë penale dhe të drejtat e njeriut që punon për promovimin e një bashkëpunim gjyqësor të drejtë dhe efektiv brenda Evropës. Aktualisht janë mbi 185 anëtarë organizativë, me përfaqësues nga firma juridike, OShC-të dhe institucione akademike, që mbulojnë të gjitha 28 shtetet anëtare të BE-së.

Përmes koordinimit të “Fair Trial”, LEAP është në gjendje të ofrojë një pikëpamje profesionale mbi një gamë të gjerë temash të drejtësisë penale të BE-së, duke rritur gjithashtu bashkëpunimin ndërmjet mbrojtësve të të drejtave të njeriut në punën ndërkufitare. Rëndësia e LEAP është pranuar nga BE, e cila ka njohur kontributin e rrjetit në Drejtësinë e BE-së.

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni:

**Laure Baudrihay-Gérard**, Avokate, në [laure.baudrihay@fairtrials.net](mailto:laure.baudrihay@fairtrials.net).

**SilviaLorenzoPerez**, Asistent Ligjor dhe i Politikave, në [silvia.lorenzoperez@fairtrials.net](mailto:silvia.lorenzoperez@fairtrials.net).

**GianlucaCesaro**, Zyrtar i Komunikimit, në [gianluca.cesaro@fairtrials.net](mailto:gianluca.cesaro@fairtrials.net).

Ky publikim është mbështetur financiarisht nga Programi për Drejtësi i Bashkimit Evropian. Përmbajtjet e këtij publikimi janë nën përgjegjësinë e vetme të “FairTrialsInternational” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të nënkuptohen se pasqyrojnë pikëpamjet e Komisionit Evropian



*Mbështetur nga Programi për Drejtësi i Bashkimit Evropian.*

*Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm eFairTrialsdhe në asnjë mënyrë nuk mund të nënkuptohen se pasqyrojnë pikëpamjet e Komisionit Evropian.*

## TABELA E PËRMBAJTJES

### Përmbajtja

I.	HYRJE.....	4
A.	Historiku.....	4
II.	OBJEKTIVAT E KËTIJ MANUALI .....	5
III.	FUSHËVEPRIMI I MANUALIT .....	7
IV.	NJE VËSHTRIM I SHKURTËR MBI DIREKTIVËN .....	7
V.	DISPOZITAT E DIREKTIVËS.....	9
A.	Fushëveprimi i Direktivës për Ndhmën Juridike .....	9
B.	Përkufizimi i ndihmës juridike.....	13
C.	Ndihma juridike në procedurën penale .....	18
D.	Ndihma juridike në procedurat e urdhër arrestit evropian .....	24
E.	Vendimmarrja për ndihmë juridike.....	25
F.	Cilësia e shërbimeve të ndihmës juridike dhe trajnimi.....	27
G.	Mjetet juridike për shkeljet e së drejtës në ndihmë juridike (Besniku).....	31
H.	Ndihma juridike e të dyshuarit të cenusshëm.....	34
VI.	PËRDORIMI I DIREKTIVËS PARA AFATIT TË TRANSPOZIMIT TË SAJ.....	35
A.	Jurispodencat e GJED-së .....	35
B.	Disa ide para përfundimit të afatit.....	36
VII.	PËRFUNDIM .....	38

# I. HYRJE

## A. Historiku

1. Në dekadën e fundit, shtetet anëtare të BE-së kanë bashkëpunuar ngushtë lidhur me çështjet ndërkufitare, kryesisht nëpërmjet mekanizmave për njohje të ndërsjellë, siç është Urdhër Arresti Evropian ('EAW'). Efikasiteti i mekanizmave të tillë varet nga besimi i ndërsjellë mes autoriteteve gjyqësore që secili do të respektojë të drejtat e personave relevant, në veçanti siç garantohen me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ").
2. Megjithatë, bashkëpunimi është dëmtuar nga fakti që autoritetet gjyqësore të cilat janë të thirrura të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, në realitet nuk kanë besim të plotë në njëri-tjetrin sa i përket respektimit të këtyre standardeve. Për të fuqizuar sistemin, BE-ja ka filluar vendosjen e standardeve minimale për rregullimin e aspekteve të caktuara të procedurës penale nëpërmjet një programi të quajtur "Udhërrëfytesa i të Drejtave Procedurale (Procedural Rights Roadmap)".<sup>1</sup>
3. Përderisa këto masa e kanë origjinën në sigurimin e besimit të ndërsjellë, rezultati është një grup i direktivave që janë të detyrueshme për autoritetet kombëtare në të gjitha rastet, duke përfshirë edhe ato pa ndonjë element ndërkufitar. Këto mbulojnë të drejtën për interpretim dhe përkthim,<sup>2</sup> të drejtën për informim,<sup>3</sup> të drejtën për të pasur një avokat<sup>4</sup>, të drejtën e ndihmës juridike<sup>5</sup>, të drejtën për prezumim të pafajësisë dhe pjesëmarrjes në gjykim<sup>6</sup> dhe të drejtat e fëmijëve në procedura penale<sup>7</sup>, të drejtën e ndihmës juridike<sup>8</sup> (Direktiva Udhërrëfytese).
4. Në këtë manual diskutohet Direktiva 2016/1919 mbi ndihmën juridike për të dyshuarit dhe personat e akuzuar në procedurat penale dhe për personat e kërkuar në procedurat e Urdhër Arrestit Evropian ("Direktiva"). Kjo Direktivë është e lidhur ngushtë me Direktivën 2013/48 mbi të drejtën për qasje në avokat ("Direktiva mbi të drejtën për të pasur një avokat") dhe ka për qëllim që të japë garanci efektive të dyshuarve dhe personave të akuzuar sipas asaj Direktive në fazat e hershme të procedurës. Për më tepër, Direktiva parasheh që personat e kërkuar në procedurat e Urdhër Arrestit Evropian kanë qasje në ndihmë juridike për të siguruar të drejtën e përfaqësimit të dyfishtë, që është e drejta për t'u asistuar nga një avokat, për të dyja shtetet si në Shtetin Anëtar zbatues po ashtu edhe në atë lëshues.
5. Ndhima juridike është thelbësore për arritjen e qasjes së barabartë në drejtësi siç është përcaktuar në nenin 6 (3) të KEDNJ-së. Siç theksohet nga Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi Qasjen në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale ("**Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së**")<sup>9</sup>, ndihma juridike është një element thelbësor i një sistemi të drejtë të

<sup>1</sup> Rezoluta e Këshillit e datës 30 nëntor 2009 mbi Udhërrëfytesin për përforcimin e të drejtave procedurale të personave të dyshuar ose të akuzuar në procedurën penale (OJ 2009 C 295, p.1)

<sup>2</sup> Direktiva 2010/64/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e përkthimit dhe interpretimit në procedurën penale, (OJ 2010 L 280, p. 1).

<sup>3</sup> Direktiva 2012/13/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procedurën penale (OJ 2012 L 142, p. 1).

<sup>4</sup> Direktiva 2013/48/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2013 mbi të drejtën për të pasur një avokat në procedimet penale dhe në procedurën e urdhër arrestit evropian dhe mbi të drejtën për të informuar palën e tretë mbi të provuarit nga liria dhe të komunikojnë me personat e tretë dhe me autoritetet konsullore gjatë kohës që është i privuar nga liria (OJ 2013 L 290, p. 1).

<sup>5</sup> Direktiva (EU) 2016/1919 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi ndihmën juridike për të dyshuarit dhe të akuzuarit në procedimet penale dhe për personat e kërkuar në procedurat e Urdhër Arrestit Evropian (OJ 2016 L 297, p.1).

<sup>6</sup> Direktiva (EU) 2016/343 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 mars 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë prezent në procesin gjyqësor, (OJ 2016 L 65, p. 1)

<sup>7</sup> Direktiva (EU) 2016/343 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 mars 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë prezent në procesin gjyqësor, (OJ 2016 L 65, p. 1)

<sup>8</sup> Direktiva (EU) 2016/1919 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi ndihmën juridike për të dyshuarit dhe të akuzuarit në procedurën penale dhe për personat e kërkuar në procedurat e Urdhër Arrestit Evropian, (OJ 2016 L297/1, P.1).

<sup>9</sup> Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi Qasjen në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë

drejtësisë penale që bazohet në sundimin e ligjit. Ajo është parakusht për ushtrimin efektiv të së drejtës për të pasur një avokat siç është përcaktuar në Direktivën mbi të drejtën për qasje në avokat për njerëzit që nuk kanë burime të mjaftueshme financiare. Për më tepër, ofrimi i ndihmës juridike forcon “barazinë e armëve” midis mbrojtjes dhe prokurorisë, si dhe prezumimin e pafajësisë së një personi të dyshuar/të akuzuar. Ndihma juridike ka përfitime më të gjera për sistemin në tërësi. Një sistem funksional i ndihmës juridike mund të zvogëlojë kohëzgjatjen e kohës që i dyshuari mbahet në stacionet e policisë dhe në qendrat e paraburgimit. Një sistem efektiv i ndihmës juridike kontribuon në reduktimin e dënimeve të gabuara, mbipopullimin e burgjeve dhe mbingarkesat në gjykata.

## II. OBJEKTIVAT E KËTIJ MANUALI

6. Afati i fundit për transpozimin e Direktivës në legjislacionin kombëtar është 25 maj 2019. Para kësaj, Shtetet Anëtare duhet të bëjnë një rishikim të ligjit kombëtar për të vlerësuar përputhshmërinë me Direktivën. “FairTrials” do të punojnë me anëtarët e LEAP dhe me ekspertë të tjerë të drejtësisë penale për të siguruar që Direktiva të transpozohet dhe zbatohet në mënyrë efektive.
7. Ky Manual synon të ndihmojë lexuesit të identifikojnë fushat ku legjislacioni kombëtar aktual ose i propozuar nuk arrin të përmbushë kërkesat e Direktivës (lexohet së bashku me standardet e tjera ndërkombëtare) në mënyrë që këto të mund të adresohen në periudhën para transpozimit, duke lënë më pak probleme për trajtim nga gjykatat. Kjo është një mundësi interesante për praktikuesit, organizatat e shoqërisë civile dhe akterë tjerë që të përfshihen dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e transpozimit të Direktivës nëpërmjet reformës legjislative dhe proceseve gjyqësore vendase.
8. Raporti i “FairTrials” me titull “Drejt Lëvizjes së BE-së mbi të Drejtën për t’u Mbrojtur” (*Towards an EU Defence Rights Movement*)<sup>10</sup>, LEAP ka kontribuar në diskutimet legjislative kombëtare në lidhje me zbatimin e Direktivave udhërrëfyese. Në Lituanë është marrë në konsideratë një parashtrësë e bërë nga FairTrials’ dhe anëtarët Lituanëz të LEAP, në konsultim me anëtarin e LEAP, Institutin për Monitorimin e të Drejtave të Njeriut dhe disa nga ndryshimet e rekomanduara janë përfshirë në tekstin përfundimtar legjislativ.<sup>11</sup> Në Spanjë, “FairTrials” së bashku me “Rights International Spain” dhe disa OJQ tjera shkruan një letër të përbashkët, duke komentuar mbi draftin e masës legjislative që zbaton dy direktivat e para të udhërrëfyesit. Gjithashtu, “Fair Trials” punoi me “JUSTICE”, anëtare e LEAP për Anglinë dhe Uellsin, me qëllim që të kontribuohet në konsultimin qeveritar mbi zbatimin e Direktivës mbi të Drejtën për Informim, me disa nga rekomandimet tona të pasqyruara në masat e aprovuara. Kjo tregon që mund të arrihet shumë në aspektin e sigurimit të zbatimit efikas të direktivës nëse LEAP dhe akterët tjerë përfshihen në mënyrë aktive në procesin e transpozimit.
9. Ky Manual ofron një pasqyrë të dispozitave të Direktivës në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike dhe përmban një rishikim të standardeve përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe një rishikim të praktikës gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (‘GJEDNJ’) që do të ndihmojë në interpretimin e këtyre dispozitave. Duke qenë se Direktiva nuk ka arritur afatin e saj të transpozimit, ajo ende nuk ka efekt të drejtpërdrejtë në Shtetet Anëtare. Megjithatë, siç diskutohet në manualin “Përdorimi i të Drejtës së BE-së në Praktikën Penale”

---

Penal, 28 mars 2013, A/RES/67/187, shih linkun: <http://www.refworld.org/docid/51e6526b4.html>.

<sup>10</sup>LEAP, Strategjiti për Zbatimin Efektiv të Direktivave Udhërrëfyese: Towards an EU Defence Rights Movement, 2015, para 29.

<sup>11</sup>FairTrials dhe LEAP, Parashtrësë në Komitetin e Çështjeve Ligjore të Parlamentit të Lituanisë mbi transpozimin e Direktivës 2012/13/EU mbi të drejtën e informimit në procedurën penale, 2014, shih linkun: <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/Lithuania-Parliament-Submission-English1.pdf>.

(Using EU Law in Criminal Practice Toolkit)të botuar nga FairTrials në vitin 2015, ekziston një numër i mënyrave në të cilat direktivat mund të përdoren për proces gjyqësor në këtë fazë.<sup>12</sup>Kështu, inkurajojmë lexuesit që të shqyrtojnë këtë Manual në lidhje me Përdorimin e së drejtës së BE-së në praktikën penale.

10. Ky Manual është një mundësi për FairTrials dhe LEAP për të mbledhur informacion nga praktikantët rreth sfidave me të cilat ata ballafaqohen për çdo ditë në praktikë kur mbrojnë të drejtën e klientit të tyre për të pasur qasje në ndihmën juridike dhe të ushtrojnë një mbrojtje efektive në faza të ndryshme të procedurës penale. Prandaj, për secilin aspekt të së drejtës për ndihmë juridike të mbuluar në Manual, kemi përfshirë një sërë pyetjesh lidhur me çështjet e ndryshme që janë në rrezik kur sigurojmë mbrojtje efektive të së drejtës në fjalë, në mënyrë që kjo të reflektojë tek lexuesi. Jemi të etur të dëgjojmë se çfarë është duke funksionuar dhe çfarë jo, si reagojnë ligjvënësit vendas, autoritetet hetuese dhe gjykatat, dhe çfarë suksesi jeni duke arritur nëpërmjet ideve dhe argumenteve të paraqitura në Manualin tonë. Ftojme lexuesit që të qëndrojnë në kontakt me FairTrials për të shkëmbyer përvojat tuaja dhe mendimet e mëtejshme. FairTrials gjithashtu do të organizojë një seri takimesh për të diskutuar këto çështje.
11. Është e mundur të arrihet më shumë përmes partneriteteve dhe diskutimeve me akterët kyç vendor të tilla si shoqatat e avokatëve, policinë, prokurorët, gjyqësorin, universitetet, shoqërinë civile dhe organet trajnuese. Në të vërtetë, shpresojmë që LEAP dhe të gjithë akterët brenda sistemeve ligjore kombëtare do mund të punojnë së bashku në hartimin e strategjive që janë specifike për vendin, në mënyrë që të adresohen sfidat e identifikuara si rezultat i pyetjeve të propozuara në këtë manual.
12. Në përmbledhje, objektivat e këtij Manuali janë:
  - A. Ofrimi i një pasqyre të dispozitave kryesore të Direktivës në lidhje me Direktivat e tjera ekzistuese udhërrëfyese dhe standardet ndërkombëtare, si dhe jurisprudenca relevante nga gjykatat rajonale;
  - B. Ofrimi i udhëzimeve se si mund të përdoret Direktiva gjatë periudhës së para-transpozimit;
  - C. Inkurajimi i anëtarëve të LEAP dhe rrjeteve të tyre për të identifikuar problemet me të drejtën dhe praktikën kombëtare që mund të adresojë Direktiva; dhe
  - D. Ofrimi i një kornize për zhvillimin e strategjive për të informuar rreth reformave juridike vendore dhe ndryshimeve në praktikë me qëllim të transpozimit dhe zbatimit efektiv të Direktivës.

---

<sup>12</sup>Shih FairTrials, 'Përdorimi i së drejtës së BE-së në praktikën penale Manualit, 2014, p 12, shih linkun: <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/Using-EU-law-A2L-FINAL1.pdf>

### III. FUSHËVEPRIMI I MANUALIT

13. Ky Manual mbulon aspektet e të së drejtës për ndihmë juridike të mishëruara në Direktivë, veçanërisht (i) fushëveprimin e së drejtës për ndihmë juridike, ii) përkufizimin e ndihmës juridike, iii) kriteret e pranueshmërisë, iv) të drejtën e qasjes në ndihmën juridike në procedurat e Urdhër Arrestit Evropian, v) marrjen e vendimeve për ndihmë juridike, vi) cilësinë e ndihmës juridike dhe trajnimin e ofruesve të ndihmës juridike, vii) mjetet juridike ndaj shkeljes të së drejtës për ndihmë juridike, viii) mbrojtje të veçanta të nevojshme për personave cenueshëm.

### IV. NJE VËSHTRIM I SHKURTËR MBI DIREKTIVËN

Dispozitat	Çfarë mbulon	Aspektet e veçanta
Neni 1	Çështja e lëndore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton rregulla minimale në lidhje me ndihmën juridike për të dyshuarit dhe personat e akuzuar në procedurën penale.</li> <li>• Gjithashtu zbatohet për personat e kërkuar në procedurat e Urdhër Arrestit Evropian.</li> <li>• Ajo plotëson Direktivat mbi të drejtën për të pasur një Avokat dhe Presumimin e Pafajësisë dhe nuk duhet të interpretohet në atë mënyrë që do të kufizonte të drejtat e parashikuara në ato Direktiva.</li> </ul>
Neni 2 Deklamime 10 – 16	Fushëveprimi	<p>Direktiva zbatohet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• personat në procedurë penale të cilët kanë të drejtë për një avokat dhe që janë:               <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) privuar nga liria;</li> <li>(b) që u kërkohet të ndihmohen nga një avokat në përputhje me ligjin kombëtar e ose të Unionit ose;</li> <li>(c) u kërkohet ose lejohet të marrin pjesë në një akt hetimor ose mbledhje të provave;</li> </ul> </li> <li>• personat e kërkuar sipas një Urdhër Arresti Evropian, të cilët kanë të drejtë për qasje në avokat, pas arrestimit nga Shteti zbatues;</li> <li>• persona të cilët fillimisht nuk ishin të dyshuar ose të akuzuar, por u bënë të tillë gjatë marrjes në pyetje;</li> <li>• në lidhje me kundërvajtje:               <ul style="list-style-type: none"> <li>a) kur ligji parashikon vendosjen e një sanksioni nga një autoritet tjetër përveç gjykatës; ose</li> <li>b) ku privimi nga liria nuk mund të shqiptohet si sanksion.</li> </ul> </li> <li>• në çdo rast, kur një vendim për paraburgim është marrë dhe gjatë paraburgimit, në çdo fazë të procedurës deri në përfundim të saj..</li> </ul>
Neni 3, Deklamimet8	Përkufizim	<ul style="list-style-type: none"> <li>• “Ndhma juridike” do të thotë financimi nga një Shtet Anëtar i ndihmës juridike përmes një avokati, duke bërë të mundur ushtrimin e së drejtës për qasje në avokat.</li> </ul>

Dispozitat	Çfarë mbulon	Aspektet e veçanta
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sipas deklamimit 8, autoritetet kompetente mund të kërkojnë që të dyshuarit, personat e akuzuar ose personat e kërkuar të marrin pjesë në shpenzimet e ndihmës juridike, varësisht nga burimet e tyre financiare.</li> </ul>
<p>Neni 4 Deklamimet 17 – 19</p>	<p>Ndihma juridike në procedurën penale</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ata që nuk kanë burime të mjaftueshme për të paguar ndihmën e një avokati, të kenë të drejtën e ndihmës juridike kur kërkohet në interes të drejtësisë.</li> <li>• Shtetet Anëtare në mënyrë që të vendosin për ofrimin e ndihmës ligjore mund të aplikojnë testin financiar, testin e meritës apo të dytë së bashku.</li> <li>• Për vlerësim të gjendjes financiare, Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh faktorë objektivë, si për shembull të ardhurat, kapitalin dhe gjendjen e familjes së personit në fjalë, si dhe koston e ndihmës së avokatit dhe standardin e jetesës.</li> <li>• Për testin e meritës, Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh seriozitetin e veprës penale, kompleksitetin e rastit dhe ashpërsinë e dënimit në fjalë. Në çdo rast, vërtetimi i meritave do të konsiderohet se është përmbushur në situatat vijuese: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) në seancën e paraburgimit, në çdo fazë të procedurës; dhe</li> <li>b) gjatë paraburgimit.</li> </ul> </li> <li>• Ndihma juridike duhet të jepet pa vonesa të panevojshme, dhe më së voni para marrjes në pyetje nga autoriteti kompetent ose përpara çdo akti hetimor apo grumbullimit të provave.</li> <li>• Ndihma juridike duhet të jepet vetëm për qëllimet e procedurës penale në të cilën personi në fjalë dyshohet ose akuzohet për kryerjen e një vepre penale.</li> </ul>
<p>Neni 5 Deklamimet 20 – 23</p>	<p>Ndihma juridike në procedurat e Urdhër Arrestit Evropian</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shteti Anëtar ekzekutues duhet të sigurojë që personat e kërkuar të kenë të drejtën e ndihmës juridike me rastin e arrestimit sipas një Urdhër Arresti Evropian derisa të dorëzohen ose deri në momentin kur vendimi për mosdorëzimin e tyre të bëhet i plotfuqishëm.</li> <li>• Shteti Anëtar lëshues duhet të sigurojë që personat e kërkuar që ushtrojnë të drejtën e tyre për të emëruar një avokat në shtetin anëtar lëshues për të ndihmuar avokatin në shtetin anëtar ekzekutues kanë të drejtën e ndihmës juridike në shtetin lëshues për qëllimet e një procedure të tillë në shtetin ekzekutues, për sa kohë që ndihma juridike të jetë e nevojshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi.</li> </ul>



Dispozitat	Çfarë mbulon	Aspektet e veçanta
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• E drejta për ndihmë juridike në procedurat e Urdhër Arrestit Evropian mund t'i nënshtrohet vlerësimit të gjendjes financiare, i cili zbatohet <i>mutatis mutandis</i>.</li> </ul>
Neni 6 Deklamimi 24	Vendimet lidhur me dhënien e ndihmës juridike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendimet për dhënien e ndihmës juridike dhe për caktimin e avokatëve duhet të bëhen pa vonesa të panevojshme, nga një autoritet kompetent.</li> <li>• Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura për të siguruar që autoriteti kompetent merr vendimet e tij me kujdes, duke respektuar të drejtat e mbrojtjes.</li> <li>• Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që të dyshuarit, personat e akuzuar dhe personat e kërkuar të informohen me shkrim nëse kërkesa e tyre për ndihmë juridike refuzohet plotësisht ose pjesërisht.</li> </ul>
Neni 7 Deklamimet 25 – 26	Cilësia e Shërbimeve të Ndhmës Juridike dhe Trajnimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme, duke përfshirë edhe ato në lidhje me financimin, për të siguruar që: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) ekziston një sistem efektiv i ndihmës juridike që është i një cilësie adekuate; dhe</li> <li>(b) shërbimet e ndihmës juridike janë të një kualiteti adekuat për të siguruar drejtësi gjatë procedurës, duke respektuar në mënyrë të duhur pavarësinë e profesionit ligjor.</li> </ul> </li> <li>• Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që trajnimi adekuat i ofrohet stafit të përfshirë në vendimmarrje për ndihmën juridike në procedurat penale dhe në procedurat e Urdhër Arrestit Evropian.</li> <li>• Shtetet Anëtare marrin masat e duhura për të promovuar ofrimin e trajnimeve adekuate për avokatët që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike.</li> <li>• Shtetet Anëtare duhet të marrin masa për të siguruar që i dyshuari ose i akuzuari mund të zëvendësojë avokatin e caktuar të ndihmës juridike, kur rrethanat specifike e arsyetojnë në gjë të tillë.</li> </ul>
Neni 8 Deklamimet 27	Mjetet juridike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të dyshuarit, personat e akuzuar dhe personat e kërkuar të kenë një mjet efektiv juridik sipas ligjit kombëtar në rast të shkeljes së të drejtave të tyre sipas kësaj Direktive.</li> </ul>
Neni 9 Deklamimet 29	Personat e cenueshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që nevojat e të dyshuarve të cenueshëm, të akuzuarve dhe personave të kërkuar të pambrojtur merren parasysh gjatë zbatimit të kësaj Direktive.</li> </ul>

## V. DISPOZITAT E DIREKTIVËS

### A. Fushëveprimi i Direktivës për Ndhmën Juridike

#### i. Çfarë thotë Direktiva

14. Neni 2 përcakton fushëveprimin e mbrojtjes së dhënë në Direktivë. E drejta për ndihmë juridike zbatohet në të gjitha fazat e procedurës, në kushte të caktuara. Megjithatë, deklamimi 9 përcakton se Direktiva nuk zbatohet kur personi që përfiton potencialisht nga ndihma juridike të ketë hequr dorë nga e drejta e tij/saj për avokat<sup>13</sup> dhe nuk e ka revokuar një heqje dore të tillë.<sup>14</sup> Përveç kësaj, Direktiva nuk zbatohet kur një Shtet Anëtar ka aplikuar përkohësisht përjashtime sipas Direktivës mbi Qasjen në Avokat, për kohën e një derogimi të tillë.<sup>15</sup> Për referencë, Direktiva për qasje në Avokat u lejon Shteteve Anëtare të heqin dorë nga detyrimi për të siguruar që të dyshuarit ose personat e akuzuar të kenë qasje në avokat vetëm në rrethana shumë të jashtëzakonshme (nevoja urgjente për të shmangur rrezikun për jetën ose integritetin e një personi; nevoja urgjente për të mbrojtur hetimin, për shkak të largësisë gjeografike e cila e dëmton mundësinë e avokatit që të ketë qasje tek klienti i tij) dhe vetëm në fazën e procedurës para-prake.<sup>16</sup>

### ***Fushëveprimi kohorë***

15. Fushëveprimi kohor i Direktivës u zgjerua sipas propozimit fillestar të Komisionit. Propozimi i fillestar parashikoi vetëm të drejtën për ndihmë ligjore të përkohshme, e cila do të mbulonte vetëm fazën para-prake të procedurës penale para se të merrej një vendim përfundimtar mbi ndihmën juridike. Në një dokument mbi qëndrimin tonë për Direktivën e propozuar, Fair Trials dhe LEAP përfshin një rekomandim që fushëveprimi i Direktivës të zgjerohet për të mbuluar ofrimin e ndihmës juridike në të gjitha fazat e procedurës penale<sup>17</sup>, në përputhje me fushëveprimin e Direktivës mbi të drejtën për qasje në avokat dhe Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara.<sup>18</sup> Parlamenti Evropian mori në konsideratë disa nga sugjerimet e LEAP, duke përfshirë këtë pikë në fushëveprimin e Direktivës.

### ***Fushëveprimi i personal***

16. Sipas seksionit 1 të nenit 2, Direktiva mbulon të dyshuarit ose personat e akuzuar në procedurë penale të cilët përfitojnë nga e drejta për të pasur një avokat sipas Direktivës dhe plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme: 1) janë të privuar nga liria; 2) që u kërkohet të ndihmohen nga një avokat në përputhje me ligjin rajonal ose kombëtar; ose 3) kërkohet ose lejohet të marrë pjesë në një akt hetimor ose mbledhje të provave, duke përfshirë paradën e identifikimit, konfrontimet ose rikrijimet e vendit të krimit.<sup>19</sup>

17. Lidhur me nevojën për t'u privuar nga liria, deklamimi 15 specifikon se, me kusht që ato të kryhen në përputhje me të drejtën për një gjykim të drejtë, situatat e mëposhtme nuk konsiderohen si privim nga liria: 1) identifikimi i të dyshuarit ose personi i akuzuar; 2);

<sup>13</sup>Në përputhje me Nenin 9 ose Nenin 10 (3) i Direktivës mbi të drejtën për të pasur një avokat.

<sup>14</sup>Deklamim 9. Për të përcaktuar nëse një heqje dorë nga e drejta për një avokat është e vlefshme, konsultohuni me Fair Trials, 'RoadmapPractitionersTool'; e drejta për të pasur një avokat, 2016, shih linkun: <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/A2L-Toolkit-FINAL.pdf>.

<sup>15</sup>Deklamim 9.

<sup>16</sup>Neni 3(5) dhe (6) i Direktivës mbi të drejtën për të pasur një avokat.

<sup>17</sup>Dokumenti mbi qëndrimin në lidhje me direktivën e propozuar për ndihmën e përkohshme juridike për të dyshuarit ose personat e akuzuar të privuar nga liria dhe ndihmën juridike në procedimet e urdhër arrestit evropian, 2015, shih linkun: <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/Position-Paper-on-Legal-Aid.pdf>.

<sup>18</sup>UNODC, Parimet dhe Udhëzimet mbi Qasjen në Ndihmën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale, 2013, në linkun: [http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/UN\\_principles\\_and\\_guidelines\\_on\\_access\\_to\\_legal\\_aid.pdf](http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/UN_principles_and_guidelines_on_access_to_legal_aid.pdf).

<sup>19</sup>Neni 2 (1).

përcaktimi nëse duhet të fillojë një hetim; 3) verifikimin e posedimit të armëve ose çështje të tjera të ngjashme të sigurisë; 4) kryerjen e veprimeve hetimore ose të mbledhjes së provave si kontrollet e trupit, ekzaminimet fizike, gjakut, alkoolit ose testet e ngjashme, ose marrjen e fotografive ose të gjurmëve të gishtave; dhe 5) duke e çuar personin e dyshuar ose të akuzuar të paraqitet para një autoriteti kompetent, në përputhje me ligjin kombëtar.<sup>20</sup>

18. Lidhur me kërkesën për të ofruar ndihmë juridike për një person të dyshuar ose të akuzuar i cili kërkohet të marrë pjesë gjatë një akti hetimor ose mbledhje të provave, deklamimi 17 specifikon se Direktiva përcakton vetëm standardet minimale. Prandaj, Shtetet Anëtare mbajnë një diskrecion të gjerë për të dhënë ndihmë juridike përtej situatave të parashikuara në Direktivë.<sup>21</sup>
19. Në kontekstin e procedurave të Urdhër Arrestit Evropian, sipas Seksionit 2 të Nenit 2, Direktiva zbatohet edhe për personin e kërkuar me rastin e arrestimit në Shtetin Anëtar ekzekutues.<sup>22</sup>
20. Seksioni 3 përcakton se Direktiva zbatohet edhe për “personat që fillimisht nuk kanë qenë të dyshuar ose të akuzuar, por bëhen të dyshuar ose të akuzuar gjatë marrjes në pyetje nga policia ose nga një autoritet tjetër i zbatimit të ligjit”<sup>23</sup>. Siç pasqyrohet në Direktivën mbi Prezumimin e Pafajësisë, të dyshuarit ose personat e akuzuar kanë të drejtë të heshtin dhe të mos inkriminojnë veten e tyre<sup>24</sup>. Prandaj, një person i cili fillimisht është thirrur për tu marrë në pyetje, por jo si i dyshuar ose i akuzuar, duhet të ketë të drejtën për mos ta inkriminuar veten dhe të drejtën për të heshtur që nga momenti kur dyshohet se ka kryer një krim<sup>25</sup>. Prandaj, në këto situata, marrja në pyetje duhet të pezullohet menjëherë në mënyrë që personi të njoftohet për të drejtat e tij/saj dhe të njoftohet se ai/ajo është bërë i/e dyshuar ose i/e akuzuar gjatë hetimeve të policisë. Marrja në pyetje mund të rifillohet vetëm pasi personi të jetë informuar në mënyrë të rregullt për të drejtat e tij/saj, duke përfshirë ndihmën juridike.<sup>26</sup>

### ***Fushëveprimi material***

21. Seksioni 4 i nenit 2 përjashton veprat e kundërvajtjes nga fushëveprimi i Direktivës në rrethana specifike. Direktiva zbatohet vetëm për procedurat para një gjykate kompetente në çështjet penale kur: (a) ligji i një Shteti Anëtar parashikon vendosjen e një sanksioni nga një autoritet tjetër përveç gjykatës kompetente në çështjet penale dhe vendosja e një sanksion i tillë mund të apelohej ose t'i referohet një gjykate të tillë; ose (b) privimi nga liria nuk mund të shqiptohet si sanksion.<sup>27</sup>
22. Deklamimi 11 dhe 12 përdorin shembullin e shkeljeve të trafikut për të ilustruar arsyetimin e këtij përjashtimi, duke qenë se në shumë Shtete Anëtare këto lloje të veprave konsiderohen vepra penale që zakonisht dënohen me gjobë (ose dënime të tjera, por jo të privuarit nga liria) dhe trajtohet nga një autoritet i ndryshëm nga gjykata penale, pra nga një autoritet administrativ ose komunal. Megjithatë, ligji në shumicën e Shteteve Anëtare lejon mundësinë për të apeluar një vendim të marrë në shkallë të parë nga një gjykatë administrative në një gjykatë penale. Prandaj, sipas Nenit 2 (4), ndihma juridike duhet të vihet në dispozicion vetëm në kontekstin e

<sup>20</sup>Deklamimi 15

<sup>21</sup>Deklamimi 17

<sup>22</sup>Neni 2(2).

<sup>23</sup>Neni 2 (3)

<sup>24</sup>Direktiva (EU) 2016/343 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 mars 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë, Neni 7

<sup>25</sup>Deklamimi 10

<sup>26</sup>Deklamimi 10

<sup>27</sup>Neni 2(4).

procedimeve para gjykatës penale në shkallën e dytë ose të tretë, por jo në procedurën në shkallë të parë përpara një gjykate administrative..

ii. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale

23. Lidhur me përjashtimin e kundërvajtjeve, standardet ndërkombëtare dhe rajonale ofrojnë udhëzime për interpretimin e mundshëm të Direktivës. Mbrojtja e garantuar sipas nenit 6 (3) të KEDNJ zbatohet për "gjithë personat që akuzohen për vepra penale".<sup>28</sup>GJEDNJ është e thirrur të interpretojë atë që përbën një "vepër penale". Autoritetet kombëtare i klasifikojnë veprat si penale, disiplinore apo administrative sipas ligjit kombëtar, dhe kjo mund të përjashtojë kundërvajtjet nga fushëveprimi i ndihmës juridike. Por klasifikimi kombëtar nuk përcakton nëse një vepër është "penale" apo jo. Për të vendosur nëse mund të thuhet se një person është "akuzuar për një vepër penale" për qëllimet e garancive të parashikuara në nenin 6 (3) (c) të KEDNJ-së, GJEDNJ zbaton të ashtuquajturit "**kriteri i Engelit**"

**Praktika gjyqësore Engel e GJEDNJ-së**

*Rasti Engel*<sup>29</sup> trajton veprimet e ndërmarra kundër anëtarëve të forcave të armatosura mbi një shkelje të mosbindjes, të klasifikuara në Holandë si shkelje e natyrës disiplinore. Pavarësisht nga klasifikimi kombëtar, GJEDNJ-ja vendosi që duhet të merren parasysh tre faktorë për të përcaktuar nëse një vepër është "penale" dhe, për rrjedhojë, nëse personi i akuzuar duhet të marrë mbrojtjen e plotë gjyqësore të përcaktuar sipas nenit 6 të KEDNJ-së.<sup>30</sup>

Këta faktorë janë:

1. Klasifikimi i veprës penale sipas ligjit kombëtar;
2. Natyra thelbësore e veprës penale. Në përcaktimin nëse natyra e veprës penale është penale, GJEDNJ konsideron se kush zbaton ligjin dhe qëllimin e dënimit. Nëse ligji zbatohet vetëm për një grup të kufizuar njerëzish, vepra penale ka më shumë gjasa të jetë disiplinore.<sup>31</sup> Megjithatë, nëse ligji ka një zbatim të përgjithshëm, ka më shumë gjasa të jetë e natyrës penale.<sup>32</sup> Nëse ndëshkimi është masë parandaluese edhe ndëshkimore atëherë konsiderohet të jetë penale;<sup>33</sup> dhe
3. Natyra dhe shkalla e ashpërsisë së dënimit që mund të shqiptohet, në veçanti duke pasur parasysh çdo humbje të lirisë, që është karakteristike e përgjegjësisë nga natyra penale.<sup>34</sup> Kur dënimi potencial është i një natyre monetare, GJEDNJ-ja vlerëson nëse qëllimi i dënimit në fjalë është kompensimi për dëmin ose dënimi për të parandaluar sjelljen e ardhshme kriminale. Në rastin e fundit, kjo vepër konsiderohet të jetë e natyrës penale<sup>35</sup>

24. Këta faktorë nuk janë kumulativ por tregues. GJEDNJ-ja më së paku rëndësi i jep faktorit të parë, përkatësisht klasifikimit kombëtar të veprës penale. Në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, shkeljet e vogla që mund të klasifikohen si "administrative" ose "disiplinore" në të drejtën kombëtare, mund të konsiderohen si "kriminale" në bazë të faktorëve të mësipërm për qëllimet e të drejtave të gjykimit të drejtë të garantuar me nenin 6 (3) të KEDNJ-së.
25. Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës rekomandon që Shtetet të heqin sistemet sipas të cilave personat që akuzohen për lloje të caktuara të veprave penale, të tilla si kundërvajtje, nuk kanë të drejtë për ndihmë juridike.<sup>36</sup> Në raportin e vendit të tij të vitit 2011 në Holandë, KPT-ja theksoi se sipas

<sup>28</sup>GJEDNJ, Neni 6(3).

<sup>29</sup>*Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, 8 qershor 1976, Seria A nr. 22.

<sup>30</sup>Shih gjithashtu McBride, 'Të Drejtat e Njeriut dhe Procedura Penale - praktika gjyqësore e GJEDNJ-së', botimi i Këshillit të Evropës, 2009, shih linkun: [https://www.echr.coe.int/documents/pub\\_coe\\_criminal\\_procedure\\_2009\\_eng.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/pub_coe_criminal_procedure_2009_eng.pdf).

<sup>31</sup>*Ezeh dhe Connors kundër v. the Mbretërisë së Bashkuar* [GC], 39665/98 and 40086/98, 9 tetor 2003, para. 101-104.

<sup>32</sup>Ibid.

<sup>33</sup>Ibid.

<sup>34</sup>*Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, 8 qershor 1976, paragrafi 82

<sup>35</sup>*Ezeh dhe Connors kundër v. the Mbretërisë së Bashkuar* [GC], 39665/98 and 40086/98, 9 tetor 2003, para. 101-104.

<sup>36</sup>Raport mbi vizitën në Holandë të kryer nga KPT nga 10 deri 21 tetor 2011, par. 18.

Kodit Penal holandez, personat e dyshuar për kundërvajtje nuk kanë pasur të drejtë për asistencë ligjore të paguar nga Bordi i Ndhmës Juridike. KPT-ja ka rekomanduar që ky kufizim të hiqet nga Kodi Penal dhe rikujton që [f] "ose e drejta për të pasur një avokat të jetë plotësisht efektive në praktikë, duhet të sigurohet një dispozitë e duhur për personat të cilët nuk janë në gjendje të paguajnë për një avokat."<sup>37</sup>

### Pyetjet e para-transpozimit

A konsideroni se ka kufizime të rëndësishme në fushëveprimin material apo kohor të së drejtës për ndihmë juridike në sistemin tuaj ligjor kombëtar?

A nevojitet reforma legjislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që Direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate në lidhje me fushëveprimin personal të së drejtës për ndihmë juridike?

Në sistemin tuaj ligjor kombëtar, a keni zgjidhje të tjera jo legjislative për problemet që shihni në praktikë në lidhje me zbatueshmërinë e ndihmës juridike?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me fushëveprimin e ndihmës juridike në lidhje me të drejtën për të pasur një avokat dhe të drejtën për gjykim të drejtë që mendoni se do të ishte e dobishme t'ia adresonit GJDBE-së për sqarime?

## B. Përkufizimi i ndihmës juridike

### i. Çfarë thotë Direktiva

26. Neni 3 i Direktivës përcakton ndihmën juridike si "financim nga një Shtet Anëtar për ndihmën e një avokati, duke bërë të mundur ushtrimin e së drejtës për qasje në avokat."<sup>38</sup> Deklamimi 8 sqaron më tej se "ndihma juridike duhet të mbulojë shpenzimet e mbrojtjes së të dyshuarve, personave të akuzuar dhe personave të kërkuar". Megjithatë, këto dy dispozita paraqesin tërheqje nga përkufizimi i përfshirë në Rekomandimin e Komisionit<sup>39</sup> dhe në tekstin e draft-propozimit për Direktivën e 2013.<sup>40</sup> Deklamimi 5 i projekt propozimit përcakton që ndihma juridike duhet të mbulojë si shpenzimet e mbrojtjes ashtu edhe procedurat. "FairTrials" mirëpriti përfshirjen e një përshkrimi shumë më të gjerë të fushëveprimit të shpenzimit që duhet të mbulojë ndihma juridike, për aq sa kjo do të përfshinte pagesat e ekspertëve, taksat gjyqësore dhe çdo kosto tjetër që mund të paguhet nga i dyshuari ose i akuzuari, çfarë është e nevojshme për të siguruar "ushtrimin e së drejtës për të pasur një avokat". Në dokumentin në lidhje qëndrimin tonë ne kemi parashtruar që përkufizimi i "ndihmës juridike" në pjesën operative të Direktivës duhet të përfshijë si koston e mbrojtjes po ashtu edhe kostot e procedurës. Është zhgënjyese që jo vetëm teksti përfundimtar i Direktivës ka dështuar të merr parasysh rekomandimet tona. Siç theksohet në dokumentin mbi qëndrimin tonë, vihet re se kostoja e mbrojtjes mund të jetë më e gjerë në sistemet kontradiktore, ku shpenzimet e ekspertëve, për shembull, do të paguheshin nga gjykata. Prandaj, përkufizimi i përfshirë në Direktivë kufizon llojin e kostos që mund të mbulohet nga ndihma juridike e cila mund ta fusë mbrojtjen në një disavantazh kundrejt prokurorisë dhe në fund të fundit rrezikon "barazinë e armëve" të garantuara për të gjithë të dyshuarit dhe personat e akuzuar anëmbanë BE-së.

<sup>37</sup>Ibid

<sup>38</sup>Neni 3 i Direktivës

<sup>39</sup>Rekomandimi i Komisionit 2013 / C 378/03 të datës 27 nëntor 2013 mbi të drejtën për ndihmë juridike për të dyshuarit ose të akuzuarit në procedurën penale, shih linkun: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013H1224\(03\)&from=en](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013H1224(03)&from=en).

<sup>40</sup>Komisioni i BE-së, Propozim për Direktivë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi ndihmën e përkohshme juridike për të dyshuarit ose të akuzuarit e privuar nga liria dhe ndihma juridike në procedurat e urdhër arrestit evropian, COM(2013) 824, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52013PC0824&from=EN>.

27. Deklamimi 8 i Direktivës parashikon gjithashtu që autoritetet kombëtare duhet të jenë në gjendje të kërkojnë që të dyshuarit, personat e akuzuar ose personat e kërkuar të mbajnë vetë një pjesë të këtyre shpenzimeve, në varësi të burimeve të tyre financiare<sup>41</sup>. Teksti origjinal i propozimit të Komisionit lejoi mundësinë e mbulimit të kostove të ndihmës juridike nga të dyshuarit ose personat e akuzuar të cilët u konstatuan se nuk përmbushin kërkesat e pranueshmërisë për ndihmë juridike të zakonshme në një fazë të mëvonshme.<sup>42</sup> Në dokumentin mbi qëndrimin, "FairTrials" dhe LEAP theksuan shqetësime serioze rreth lejimit të rikuperimit të shpenzimeve në lidhje me ndihmën juridike nga të dyshuarit ose personat e akuzuar, duke pasur parasysh se në bazë të përvojës së anëtarëve të LEAP, rreziku i ardhshëm nga detyrimi që të paguhen kostos e shërbimeve ligjore mund t'i pengojnë të dyshuarit dhe personat e akuzuar që të ushtrojnë të drejtën e tyre për një avokat në fazën e rëndësishme fillestare të procedurës. Prandaj, për të siguruar që të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmën e avokatit në këto faza kritike të procedurës penale, do të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për ndihmë juridike pa u shqetësuar nëse do të detyrohen apo jo të paguajnë shpenzimet në një fazë të mëvonshme, është e domosdoshme që ndihma juridike të jepet pavarësisht vlerësimit të pranueshmërisë, qoftë asokohe ose në të ardhmen dhe pa ndonjë rrezik për rikuperimin e kostos në një të ardhme.
28. Për më tepër, Rekomandimi i Komisionit parashikon gjithashtu se, kur ndihma juridike është dhënë përmes vlerësimit të meritave, këto shpenzime mund të mbulohen në rast të një dënimi përfundimtar<sup>43</sup>. Kjo u adresua edhe në dokumentin tonë mbi qëndrimin duke e bërë të qartë se e drejta për një gjykim të drejtë dhe aspektet e ndryshme që ajo përfshin, i përkasin të gjithë të dyshuarve dhe personave të akuzuar pavarësisht nga faji apo pafajësia e tyre. Ne jemi të shqetësuar se Direktiva nuk arrin të ndalojë mundësinë që autoritetet sipas ligjit kombëtar të rikuperojnë shpenzimet pas shpalljes fajtor.<sup>44</sup>
29. Parlamenti Evropian kishte propozuar një ndryshim për të përjashtuar shprehimisht mundësinë që Shtetet Anëtare të kërkojnë shpenzime nga i pandehuri në rast të një dënimi. Komisioni i Parlamentit Evropian për liritë civile, drejtësinë dhe çështjet e brendshme ('**Komiteti LIBE**) bëri një vlerësim për të përcaktuar nëse miratimi i amendamentit të propozuar nga Parlamenti do të kishte një ndikim më pozitiv në të drejtat themelore të të pandehurit. Komiteti LIBE arriti në përfundimin se lejimi i Shteteve Anëtare që të kërkojnë shpenzime nga i pandehuri mund të ketë një ndikim negativ në të drejtat themelore të të pandehurit dhe (duke përmendur dokumentin mbi qëndrimin e FairTrials) mund të ushtrojë presion ndaj të dyshuarve dhe personave të akuzuar të heqin dorë nga e drejta e tyre për një avokat për shkak të rrezikut të përballjes me kostot e ndihmës juridike.<sup>45</sup>
30. Komiteti LIBE rekomandoi që Komisioni të miratojë një ndryshim në të cilin Shtetet Anëtare mund të mbulojnë shpenzimet e ndihmës juridike vetëm nëse mund të vërtetohet se personi nuk ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë për ndihmë juridike ose nëse personi ka dhënë informata të rreme për gjendjen e tij financiare. Në këtë mënyrë do të forcohej e drejta për qasje në avokat, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për prezumim të pafajësisë dhe e drejta për liri.
31. Në Belgjikë, Bullgari, Angli, Uells, Finlandë, Francë, Itali dhe Spanjë, ekziston një kërkesa e

<sup>41</sup>Deklamimi 8 i Direktivës.

<sup>42</sup>Komisioni i BE-së, Propozim për Direktivë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi ndihmën e përkohshme juridike për të dyshuarit ose të akuzuarit e privuar nga liria dhe ndihma juridike në procedurat e urdhër arrestit evropian, COM(2013) 824, para. 31.

<sup>43</sup>Rekomandimi i Komisionit 2013 / C 378/03 të datës 27 nëntor 2013 mbi të drejtën për ndihmë juridike për të dyshuarit ose të akuzuarit në procedurën penale, shih linkun, para. 13

<sup>44</sup>Dokumenti mbi qëndrimin, 11.

<sup>45</sup>Komisioni LIBE, Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve substanciale ndaj propozimit të Komisionit "Ndihma e përkohshme juridike për të dyshuarit ose të akuzuarit e privuar nga liria dhe ndihma juridike në procedurat e urdhër arrestit evropian", (Vlerësimi i ndikimit të Komitetit LIBE), qershor 2016, shih linkun: [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/581410/EPRS\\_STU\(2016\)581410\\_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/581410/EPRS_STU(2016)581410_EN.pdf)

rimbursimit, kur një vendim përfundimtar përcakton që personi nuk i plotëson kriteret e kualifikueshmërisë për ndihmën e zakonshme juridike sipas legjislacionit kombëtar. Po kështu, nëse i dyshuari/i akuzuari me vetëdije ka dhënë informacione të rreme, ai/ajo duhet të rimbursojë shpenzimet e ndihmës juridike.<sup>46</sup>

32. Është zhgënjyese që, megjithëse pjesa operative e Direktivës përfundimtare ashtu siç është miratuar nuk përfshin mundësinë e rikuperimit të kostos së ndihmës juridike, nuk është përjashtuar shprehimisht dhe për më tepër është mbajtur në trupin e Direktivës si Deklamimi 8. Kjo e lë derën hapur për Shtetet Anëtare që të interpretojnë Direktivën, duke mos e ndaluar në mënyrë eksplicite rikuperimin e kostove, të cilat në disa raste mund të çojnë në uljen e standardeve ekzistuese kombëtare. Megjithatë, Direktiva duhet të interpretohet në dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së, e cila ka gjetur në shumë raste që kërkesa për rimbursimin e kostove të ndihmës juridike mund të shkelë të drejtën për gjykim të drejtë në situata të caktuara (shih më poshtë).

### Hulumtimi i LEAP mbi rikuperimin e kostos (2017)

33. Në 2017, "FairTrials" anketuan anëtarët e LEAP për të identifikuar standardet ekzistuese në lidhje me rikuperimin e kostos së ndihmës juridike anëtarëve BE-së. Kemi gjetur se vetëm një pjesë e vogël e vendeve kërkojnë që ata që kualifikohen për ndihmë juridike të paguajnë ndonjë tarifë për shërbimet e tyre ligjore dhe shpesh kontributi i tillë lidhet me nivelin e të ardhurave të tyre. Në Spanjë, ata që marrin ndihmë juridike janë përgjegjës vetëm për të paguar 20% të shpenzimeve të dokumenteve të noterizuara; qeveria paguan të gjitha tarifën dhe kostot e tjera që lidhen me përfaqësimin ligjor. Në Mbretërinë e Bashkuar, ata që kanë një të ardhur vjetore të disponueshme mbi £ 3,398 duhet të paguajnë një pjesë ose të gjitha shpenzimet e procedurave në gjykatat e nivelit më të ulët, siç janë gjykatat e magistratëve dhe marrjen e vendimit për dënim; megjithatë, shumica, nëse jo të gjitha shpenzimet për krime më të rënda që ndodhin në Gjykatën e Kurorës, financohen plotësisht nga shteti. Në Suedi, para se një person të mund të marrë ndihmë juridike, ata duhet të konsultohen me një avokat për të paktën një orë por jo më shumë se dy orë dhe i pandehuri është përgjegjës për ato shpenzime, të cilat i paguhen drejtpërsëdrejti avokatit. Në varësi të të ardhurave të personit, atëherë kostoja e konsultimit mund të përgjysmohet. Individët që marrin ndihmë juridike gjithashtu duhet të paguajnë "një tarifë të përgjithshme për ndihmë juridike" që ndryshon varësisht nga të ardhurat e tyre; maksimumi që një person mund të kërkojë është 40% të tarifave të tyre ligjore dhe një minimum prej 5,000 KS. Në mënyrë të ngjashme, Holanda kërkon që personat që marrin ndihmë juridike të kontribuojnë në shpenzimet e përfaqësimit ligjor, duke filluar nga 198 në 823 euro, varësisht nga madhësia dhe të ardhurat familjes. Vendet e tjera e konsiderojnë vendosjen e një tarife vetëm nëse personi është shpallur fajtor (*Kroaci, Estoni, Lituani, Poloni dhe Hungari - vetëm nëse avokati u emërua nën një prezumim*).

<sup>46</sup>Komisioni LIBE - Vlerësimi i Ndikimit, 17.

ii. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale

34. Duke pasur parasysh përkufizimin e ndihmës juridike të përfshirë në Direktivë, e cila nuk përjashton shprehimisht rikuperimin e kostos, është e dobishme të kthehemi tek standardet ndërkombëtare dhe rajonale të cilat ofrojnë përkufizime më të gjera të ndihmës juridike sesa Direktiva dhe të përjashtojmë mundësinë e shteteve që të kërkojnë që personat që përfitojnë nga ndihma juridike të kontribuojnë në kostot e përfaqësimit ligjor. Në këtë drejtim, Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së përcaktojnë se nocioni "ndihmë juridike" duhet të përfshijë: "këshilla ligjore, ndihmë dhe përfaqësim për personat e ndaluar, arrestuar ose të burgosur, të dyshuar ose të akuzuar ose të akuzuar për vepër penale [...] që ofrohet pa kosto për ata që nuk kanë mjete të mjaftueshme ose kur kjo bëhet në interes të drejtësisë. Për më tepër, "ndihma juridike" duhet të përfshijë konceptet e edukimit ligjor, qasjen në informacionin ligjor dhe shërbimet e tjera të ofruara për personat përmes mekanizmave alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe proceseve të drejtësisë restauruese."<sup>47</sup>
35. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se Rezoluta (78) 8 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës e datës 2 mars 1978 mbi ndihmën dhe këshillën juridike thotë se ndihma juridike "duhet të sigurojë të gjitha shpenzimet që domosdoshmërishtë lindin nga personi që ndihmohet, në kërkim për mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore, në veçanti mbulimin e tarifave të avokatëve, shpenzimet e ekspertëve, dëshmitarëve dhe përkthimeve. Është e dëshirueshme që, kur të jepet ndihma juridike, çdo kërkesë për sigurimin e shpenzimeve duhet të përjashtohet."<sup>48</sup> Sa i përket rikuperimit të kostos, e njëjta rezolutë specifikon se ndihma juridike duhet të jetë e disponueshme edhe kur personi është në gjendje të paguajë një pjesë të shpenzimeve të procedurave të tij.<sup>49</sup> Në këtë rast, ndihma juridike mund të vihet në dispozicion me një kontribut financiar nga personi i ndihmuar, i cili nuk duhet të tejkalojë atë që ai person mund të paguajë pa shkaktuar vështirësi të panevojshme.
36. GJEDNJ-ja në lidhje me nenin 6 (3) (c), parasheh që e drejta për ndihmë juridike falas nuk është absolute dhe duhet të sigurohet vetëm nëse i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar.<sup>50</sup> Prandaj, GJEDNJ lejon shtetet anëtare të kërkojnë shpenzimet e ndihmës juridike nga personi i akuzuar ose i dyshuar. Megjithatë, GJEDNJ ka vendosur që kërkesa për rimbursimin e kostove të ndihmës juridike mund të shkelë të drejtën për gjykim të drejtë në situatat e mëposhtme: 1) kur shumica e kërkuar nga aplikanti është e tepruar;<sup>51</sup> 2) kur kushtet e rimbursimit janë arbitrare ose të paarsyeshme;<sup>52</sup> dhe 3) ku nuk është bërë asnjë vlerësim i gjendjes financiare të aplikantit.<sup>53</sup> Në çdo rast, GJEDNJ ka bërë të qartë se barra për të dëshmuar mungesën e mjeteve të mjaftueshme duhet të bartet nga personi që e kërkon atë.<sup>54</sup>

***Croissant kundër Gjermanisë, 25 shtator 1992, Seria A nr. 237-B***<sup>55</sup>

Aplikanti ishte përfaqësuar nga tre avokatë të caktuar nga gjykata gjatë gjithë gjykimit dhe ishte dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim; ai u urdhërua gjithashtu të paguante shpenzimet, duke përfshirë tarifën dhe pagesat e tre avokatëve mbrojtës të caktuar nga gjykata. Aplikanti u ankua se urdhri për të paguar kostot e avokatëve të caktuar nga gjykata ishte në kundërshtim me nenin 6 (3) (c), duke argumentuar se, pas aprovimit të kërkesës për ndihmë juridike falas, asnjë pagesë nuk mund të kërkohej më pas. Megjithatë, GJEDNJ-ja gjeti se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6

<sup>47</sup>Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së për Qasjen në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale, Deklamimi 8.

<sup>48</sup>Rezoluta (78) 8 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të datës 2 mars 1978 mbi ndihmën dhe këshillën juridike, shih linkun: [https://www.euromed-justice.eu/en/system/files/20090128115013\\_res%2878%298eCoE.pdf](https://www.euromed-justice.eu/en/system/files/20090128115013_res%2878%298eCoE.pdf).

<sup>49</sup>Rezoluta (78) 8 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të datës 2 mars 1978 mbi ndihmën dhe këshillën juridike, para. 1.

<sup>50</sup>*Croissant v. Germany*, 25 September 1992, para 36, Series A no. 237-B; *Orlov v. Russia*, no. 29652/04, 21 Qershor 2011.

<sup>51</sup>*Croissant v. Germany*, 25 September 1992, para 36, Series A no. 237-B; *Orlov v. Russia*, no. 29652/04, para 114, 21 June 2011.

<sup>52</sup>*Morris v. the United Kingdom*, no. 38784/97, ECHR 2002-I

<sup>53</sup>*Croissant*, para 36; *Orlov*, para 114; *Morris*, para 89

<sup>54</sup>*Croissant*, para 37.

<sup>55</sup>*Croissant v. Germany*, 25 September 1992, Series A no. 237-B.



(3) (c). GJEDNJ-ja konstatoi se avokatët ishin emëruar në interes të drejtësisë (provave të meritave) dhe jo si rezultat i një vlerësimi të gjendjes financiare të të akuzuarit (vlerësim i gjendjes financiare), në të cilin rast kërkesa për të paguar kostot do të ishte në përputhje nën 6.<sup>56</sup> GJEDNJ konstatoi se gjykatat kombëtare kishin të drejtë të konsideronin të nevojshme të caktojnë avokatët dhe se shpenzimet e përfaqësimit ligjor nuk ishin të tepërta. Për më tepër, ligji gjerman siguroi mekanizma që mund të mbulonin shpenzimet e përmendura, pjesërisht ose në pjesën më të madhe, nëse parashtuesi i kërkesës do të kishte dëshmuar mungesën e mjeteve të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet.<sup>57</sup>

Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 38784/97, GJEDNJ 2002-I<sup>58</sup>

Aplikanti kishte aplikuar për ndihmë juridike për t'u gjykuar përpara një gjykate ushtarake. Ai ishte njoftuar nga autoriteti i ndihmës juridike se ndihma juridike do të jepej në një pagesë paraprake prej 240 GBP. Aplikanti kishte refuzuar ofertën e ndihmës juridike dhe nuk ishte e përfaqësuar nga një avokat në gjykatën ushtarake. Aplikanti u ankua se të drejtat e tij për përfaqësim ligjor sipas nenit 6 (1) dhe (3) (c) të KEDNJ-së ishin shkelur. Në mënyrë të veçantë, ai argumentoi se ai kishte të drejtën e përfaqësimit ligjor, por si rezultat i sistemit të padrejtë ushtarak për ndihmë juridike, kjo atij i ishte mohuar, duke pasur parasysh se ai nuk ishte në gjendje të përballonte shumën e kërkuar. GJEDNJ nuk gjeti asnjë shkelje të Nenit 6 (1) ose 3 (c). Ajo konstatoi se kushti për të paguar një kontribut prej 240 GBP për të marrë ndihmë juridike nuk ishte arbitrar ose i paarsyeshëm, duke pasur parasysh nivelet e pagës neto të aplikantit në atë kohë.<sup>59</sup>

Orlov kundër Rusisë, nr. 29652/04, para 114, 21 qershor 2011<sup>60</sup>

Gjykata Supreme caktoi një avokat për të siguruar kërkesën për ndihmë juridike gjatë procedurës ankimore. Pas shqiptimit të dënimit në procedurën ankimore duke ulur afatin e burgimit të aplikantit, avokatja e caktuar nga gjykata kërkoi pagesën e tarifave të saj. Gjykata Supreme ka urdhëruar aplikantin që tarifat ligjore të avokatit t'ia paguaj shtetit. Aplikanti më pas u ankua se atij nuk i ishte dhënë ndihmë juridike falas në procedurën e ankimore.

Në kontrast me qëndrimin e saj në rastin Croissant dhe Morris, në këtë rast, GJEDNJ-ja konstatoi një shkelje të nenit 6 (1) dhe (3) (c) të KEDNJ-së. Gjykata konstatoi se sipas Kodit të Procedurës Penale të Rusisë, nuk kishte asnjë kërkesë për "vlerësim të gjendjes financiare" për të vendosur nëse duhet të jepet ndihmë juridike falas dhe tarifat e avokatëve janë trajtuar si "shpenzime gjyqësore" që do të barten tek personi i përfaqësuar. Prandaj, edhe nëse të pandehurit i është siguruar ndihmë juridike falas, atij/asaj prapë do t'i kërkohej të paguante për ato shpenzime pas gjykimit. Për më tepër, GJEDNJ-ja vuri në dukje se, edhe pse shpenzimet nuk dukeshin të tepruara, shuma ishte vendosur pa kryer një vlerësim të gjendjes financiare dhe rrethanave personale të të pandehurit<sup>61</sup>

37. GJEDNJ-ja parasheh që rikuperimi i kostove të ndihmës juridike në rrethana të caktuara mund të shkelë të drejtën për gjykim të drejtë.

iii. Rekomandim

<sup>56</sup>Ibid, para 36.

<sup>57</sup>Id, para 37.

<sup>58</sup>[Morris v. the United Kingdom](#), no. 38784/97, ECHR 2002-I.

<sup>59</sup>Ibid, para 89.

<sup>60</sup>[Orlov v. Russia](#), no. 29652/04, 21 June 2011.

<sup>61</sup>Orlov, para. 114.

38. Pavarësisht nga heshtja e Direktivës në këtë pikë, Shtetet Anëtare duhet të inkurajohen në procesin e zbatimit të Direktivës për të përjashtuar shprehimisht mundësinë për të mbuluar kostot e ndihmës juridike pas një dënimi të mëvonshëm. Shtetet Anëtare kanë pranuar kufizime të tilla mbi mundësinë e tyre për të mbuluar shpenzimet në lidhje me sigurimin e masave mbrojtëse në direktivat e tjera të mëparshme Udhërrëfyese (**Roadmap Directives**). Për shembull, Direktiva 2010/64 /EU për të drejtën e interpretimit dhe përkthimit me shkrim në procedurat penale (**Direktiva për Interpretim dhe Përkthim me shkrim**) thotë që "Shtetet Anëtare do të mbulojnë shpenzimet për interpretim dhe përkthim me shkrim që rrjedhin nga zbatimi i Neneve 2 dhe 3, pavarësisht nga rezultati i procedurës."<sup>62</sup>
39. Kjo dispozitë ishte e motivuar nga konstatimi se lejimi i ndonjë rikuperimi të tillë të kostove do të ndikonte në vendimin e të dyshuarit/të akuzuarit për të ushtruar të drejtat e tyre të gjyqimit të drejtë dhe prandaj do të ishte në kundërshtim me parimin se shtetet janë përgjegjëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre të drejtave.

#### **Pyetjet e para-transpozimit**

A konsideroni se ka probleme të veçanta në lidhje me përcaktimin e ndihmës juridike në juridiksionin tuaj?

A lejohen Autoritetet të mbulojnë shpenzimet e ndihmës juridike të të pandehurit? Nëse po, në cilat rrethana? A marrin parasysh autoritetet rrethanat personale ose gjendjen financiare të aplikantit për të përcaktuar shumën që mund të mbulohet?

A kërkohen të bëhen reforma legjislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që Direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate në lidhje me përkufizimin e ndihmës juridike?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me përkufizimin e ndihmës juridike në lidhje me të drejtën për një avokat dhe të drejtën për një gjykim të drejtë për të cilat ju mendoni të jetë e dobishme adresimi tek GJEDNJ-ja për sqarime?

?

### **C. Ndihma juridike në procedurën penale**

#### **i. Çfarë thotë Direktiva**

40. Neni 4 përcakton detyrimin e Shteteve Anëtare që të ofrojnë ndihmë juridike për të dyshuarit dhe personat e akuzuar të cilët nuk kanë burime të mjaftueshme për të paguar ndihmën e një avokati, kur një gjë e tillë kërkohet në interes të drejtësisë. Për këtë, autoritetet mund të aplikojnë për vërtetimin e gjendjes financiare, vlerësimin e meritave, ose të dyja. Në këtë aspekt, Deklamimi 17 i referohet nenit 6 (3) (c) të KEDNJ-së, por shkon një hap më tej se jurisprudenca e GJEDNJ-së, e cila kërkon që ndihma juridike të sigurohet pas aplikimit të vlerësimit të mjeteve dhe meritave (shih më poshtë).
41. Për të vendosur nëse një të dyshuari ose të akuzuari i mungojnë mjetet e mjaftueshme ("**vlerësimi i gjendjes financiare**"), autoritetet relevante duhet të marrin parasysh të gjithë faktorët relevantë dhe objektivë, siç janë të ardhurat, gjendja e kapitalit dhe familja e personit

<sup>62</sup>Neni 4 i Direktivës për Interpretim dhe Përkthim me shkrim.

në fjalë, kostot e avokatit dhe standardi i jetesës në shtetin anëtar në fjalë. Megjithatë, Direktiva nuk specifikon se kush mban barrën për të provuar se i dyshuari ose i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme, madje as për pragun e dëshmimeve të nevojshme që duhet të plotësohet për marrjen e ndihmës juridike. Deklamimi 18 u lë Shteteve Anëtare që të caktojnë masat praktike në lidhje me ofrimin e ndihmës juridike.

42. Për të përcaktuar nëse dhënia e ndihmës juridike është në interes të drejtësisë (**vlerësimi meritave**<sup>63</sup>), autoritetet duhet të marrin në konsideratë seriozitetin e veprës penale, kompleksitetin e rastit dhe ashpërsinë e sanksionit në fjalë. Pa marrë parasysh nëse këta faktorë përputhen, ndihma juridike duhet të sigurohet në interes të drejtësisë në situatat e mëposhtme: 1) kur personi paraqitet para një gjykate ose gjyqtari kompetent për të vendosur mbi paraburgimin në çdo fazë të procedurës brenda fushëveprimit të Direktivës; dhe 2) gjatë paraburgimit.
43. Ndhima juridike duhet të jepet sa më shpejt që të jetë e mundur në procedurë dhe, në çdo rast, përpara marrjes në pyetje (nga policia ose ndonjë autoritet tjetër gjyqësor) dhe para fillimit të akteve të lartpërmendura hetuese ose mbledhjes së provave.

ii. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale

44. Vlerësimi i gjendjes financiare dhe vlerësimin e meritave pranohen ndërkombëtarisht si kritere të përshtatshme për të përcaktuar nëse një i dyshuar ose i akuzuar ka të drejtën e ndihmës juridike. Për shembull, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (**KNDCP**) parasheh që në procedurat penale, ndihma juridike duhet të sigurohet "aty ku është në interes të drejtësisë" dhe ndihma juridike duhet të jetë falas nëse personi "nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar".<sup>63</sup>

**Vlerësimi i gjendjes financiare**

45. Parimi 3 i Parimeve dhe Udhëzimeve të OKB-së për Qasjen në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale shkon përtej standardit të KNDCP, Neni 14 (3) (d), në inkurajimin e Shteteve që të ofrojnë ndihmë juridike pa marrë parasysh mjetet e personit nëse rasti është veçanërisht urgjent ose kompleks ose nëse dënimi potencial është i ashpër<sup>64</sup>.
46. Sipas Udhëzuesit 1 të Parimeve dhe Udhëzimeve të OKB-së, "kurdo që shtetet aplikojnë vlerësimin e gjendjes financiare për përcaktimin e pranueshmërisë për ndihmë juridike ata duhet të sigurojnë që: (a) personat mjetet e të cilëve tejkalojnë kufijtë e vlerësimit të gjendjes financiare, por të cilët nuk kanë mundësi ose nuk kanë qasje në avokat në një situatë ku ndihma ligjore do t'u jepej dhe kur është në interes të drejtësisë to ofrohet një ndihmë e tillë, nuk do të përjashtohen nga marrja e kësaj ndihme"; (b) kriteret për zbatimin e vlerësimit të gjendjes financiare publikohen gjerësisht; (c) personat që kërkojnë ndihmë juridike urgjente në stacionet e policisë, qendrat e paraburgimit ose gjykatat duhet të sigurohen për ndihmë juridike para së të bëhet përcaktimi i pranueshmërisë së tyre. Fëmijët përjashtohen gjithmonë nga vlerësimi i gjendjes financiare; (d) personat të cilëve u është mohuar e drejta për ndihmë juridike në bazë të vlerësimit të gjendjes financiare kanë të drejtë të ankohen kundër këtij vendimi; (e) gjykata, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të një personi dhe pas shqyrtimit të arsyeve për mohimin e ndihmës juridike, mund ta udhëzojë atë person të pajiset me ndihmë juridike, me ose pa kontributin e tij, kur dhënia e ndihmës është në interes të drejtësisë; (f) Nëse provimi i mjeteve llogaritet mbi bazën e të ardhurave familjare të një familje, por anëtarët individual të familjes janë në konflikt me njëri tjetrin ose nuk kanë qasje të barabartë në të

<sup>63</sup>Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, 16 dhjetor 1966, neni 14 (3) (d), Kombet e Bashkuara, Seritë e Traktatit, vol. 999, p. 171, shih linkun: <http://www.refworld.org/docid/3ae6b3aa0.html>.

<sup>64</sup>Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së, Parimi 3.

ardhurat e familjes, vetëm të ardhurat e personit që aplikon për ndihmë përdoren për qëllime të vlerësimit të gjendjes financiare.”<sup>65</sup>

47. Sipas nenit 6 (3) (c) të KEDNJ-së, për dhënien e ndihmës juridike, dy kushte duhet të përputhen në mënyrë kumulative: kushti i parë, personat në fjalë duhet të kenë mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën juridike dhe kushti i dytë, kur dhënia e ndihmës është në interes të drejtësisë.<sup>66</sup>Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, gjatë zbatimit të vlerësimit të gjendjes financiare, i dyshuari ose i akuzuari mban barrën e provimit se ai/ajo nuk kanë mjete të mjaftueshme.<sup>67</sup>Megjithatë, kjo nuk duhet të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.<sup>68</sup>Për shembull, në rastin *Pakelli kundër Gjermanisë*, GJEDNJ konstatoi se megjithëse ankuesi nuk kishte paraqitur dëshmi të qarta se i mungonin burimet financiare, kishte pasur një sërë treguesish që e bënin shumë të mundshme që ai vërtet e kishte të pamundur financiarisht të barte koston e detyrimeve të tij për ndihmë ligjore<sup>69</sup>. Kjo qasje u ndoq nga Raportuesja Speciale për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, Gabriela Knaul, në Raportin e saj të vitit 2013, ku ajo deklaroi se "barra e të provuarit se nuk ka mjete të mjaftueshme i takon të akuzuarit, megjithatë, ai ose ajo nuk ka nevojë, ta bëjë këtë "kur kjo është më se e sigurt"; mjafton të ketë "disa indikacione" se kjo është ashtu"<sup>70</sup>

---

<sup>65</sup>Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së, Udhëzimi 1, para. 41.

<sup>66</sup>*Quaranta v. Switzerland*, 24 maj 1991, para. 27, Seria A no. 205; *PhamHoang v. France*, 25 shtator 1992, para. 39, Seria A no. 243; *TsonyoTsonev v. Bulgaria (no. 3)*, nr. 21124/04, para. 50, 16 tetor 2012; *ZdravkoStanev v. Bulgaria*, nr. 32238/04, para. 36, 6 nëntor 2012

<sup>67</sup>*Croissant v Germany*, para 37.

<sup>68</sup>*Pakelli v. Germany*, 25 prill 1983, para. 34, Seria A nr. 64

<sup>69</sup>*Pakelli kundër Gjermanisë*.

<sup>70</sup>Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Raport i Raportueses Speciale mbi pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, GabrielaKnaul, 15 mars 2013, A/KDNJ/23/43, para 54

Pakelli kundër Gjermanisë, 25 prill 1983, Seria A nr. 64.<sup>71</sup>

Aplikanti kishte kërkuar ndihmë juridike në mënyrë që të përfaqësohej në gjykatë nga avokati i tij i zgjedhur. Gjykata Federale refuzoi kërkesën sepse, sipas ligjit gjerman, nuk kishte kërkesë që ai ose të paraqitej personalisht ose të përfaqësohej nga një avokat në atë fazë të procedurës. Në apelimin e këtij vendimi, avokati i ankuesit pretendonte se atij i mungonin mjetet për të paguar avokatin e zgjedhur prej tij dhe se duke pasur parasysh seriozitetin e pasojave me të cilat është përballur i pandehuri në rast të një dënimi përfundimtar, ai kishte të drejtë për ndihmë juridike sepse kjo ishte në interesat e drejtësisë. Gjykata refuzoi ankesën e aplikantit dhe argumentoi se nuk kishte asnjë provë që vërtetonte pohimin e aplikantit se ai nuk kishte mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën juridike sipas zgjedhjes së tij. GJEDNJ-ja konstatoi se ishte e vështirë të vlerësohej nëse parashtruesi i kërkesës kishte apo jo mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën e tij ligjore në kohën kur u zhvillua procedura. Megjithatë, ai gjeti se kishte disa indikacione që tregonin të ishte ashtu duke pasur parasysh provat që avokati i aplikantit ishte munduar t'i paraqiste për të demonstruar mungesën e burimeve financiare, të cilat përfshinin një certifikatë të varfërisë dhe një deklaratë mbi të ardhurat dhe pasuritë. Megjithëse GJEDNJ-ja ka pranuar se prova të tilla mund të mos ishin të mjaftueshme për të vërtetuar përtej çdo dyshimi se aplikanti ishte i varfër në kohën përkatëse, GJEDNJ u bind se gatishmëria e aplikantit për të paraqitur dëshminë e përmendur dhe mungesën e indikacioneve të qarta për të kundërtën, u konstatua se aplikanti në të vërtet nuk kishte mjete të mjaftueshme. Prandaj, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 (3) (c).

48. Megjithatë, as GJEDNJ-ja as gjykatat e tjera ndërkombëtare nuk kanë dhënë një përkufizim të termit “mjete të mjaftueshme”. GJEDNJ ka vendosur që gjykatat kombëtare duhet të marrin parasysh të gjitha provat lidhur me rrethanat dhe situatën personale të aplikantit për të përcaktuar nëse rrethanat financiare të të pandehurit justifikojnë dhënien e ndihmës juridike<sup>72</sup> por edhe çdo provë që përgënjeshtrojnë aplikantin. Përveç kësaj, Rezoluta (78) 8 e Këshillit të Evropës për ndihmën juridike dhe këshillat deklaroi se kur vendoset nëse duhet të ofrohet ndihmë juridike, shtetet duhet të marrin parasysh burimet dhe detyrimet financiare të aplikuesit si dhe kostot e parashikuara të procedurës. Përveç kësaj, Rezoluta përcakton që duhet të jetë e mundur që ndihma juridike të merret gjatë rrjedhës së procedurës, nëse ka ndonjë ndryshim në burimet financiare ose detyrimet e palës ndërgjyqëse ose ndonjë çështje tjetër që kërkon dhënien e ndihmës juridike.”<sup>73</sup>

### ***Vlerësimi meritave***

49. GJEDNJ-ja gjithashtu ofron udhëzime se kur duhet të ofrohet ndihma juridike e cila është në interes të drejtësisë (*vlerësimin e meritave*). Gjykatat kombëtare duhet të marrin parasysh tre faktorët e mëposhtëm: 1) seriozitetin e veprës dhe ashpërsinë e dënimit potencial;<sup>74</sup> 2) kompleksitetin e rastit<sup>75</sup>; 3) gjendjen sociale dhe personale të pandehurit.<sup>76</sup> Megjithëse duhet të merren parasysh të tre faktorët, mjafton që njëri prej tyre të jetë në përputhje me në një rast të veçantë në mënyrë që të justifikohet dhënia e ndihmës juridike.

50. Sa i përket ashpërsisë së dënimit potencial, GJEDNJ-ja ka konsideruar se ndihma juridike mund të

<sup>71</sup>[Pakelli v. Germany](#), 25 prill 1983, Seria A no. 64.

<sup>72</sup>Pakelli kundër Gjermanisë, para. 34.

<sup>73</sup>Rezoluta (78) 8 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të datës 2 mars 1978 mbi ndihmën juridike dhe këshillat, shih linkun: [https://www.euromed-justice.eu/en/system/files/20090128115013\\_res%2878%298eCoE.pdf](https://www.euromed-justice.eu/en/system/files/20090128115013_res%2878%298eCoE.pdf).

<sup>74</sup>[Quaranta v. Switzerland](#), 24 mas 1991, para 33, Seria A no. 205.

<sup>75</sup>[Quaranta](#), para 34

<sup>76</sup>[Quaranta](#), par. 35.

ofrohet kur është në interes të drejtësisë dhe kur ekziston rreziku që i pandehuri të privohet nga liria sepse nuk mund ta paguajë vetë atë.<sup>77</sup>

51. Gjatë vlerësimit të kompleksitetit të çështjes, GJEDNJ-ja ka gjetur se ndihma juridike duhet të sigurohet në interes të drejtësisë në rastet kur, edhe pse aplikantët janë persona të arsimuar dhe mund të kuptojnë procedurat, atyre u mungon trajnimi ligjor që është thelbësor për t'ju mundësuar atyre paraqitjen dhe zhvillimin e argumenteve të përshtatshme në kontestet e lëndëve të komplikuara sepse këto veprime ligjore mund t'i ndërmarr vetëm një avokat me përvojë.<sup>78</sup>
52. Për më tepër, GJEDNJ ka gjetur se nuk është e nevojshme që personi të dëshmojë përtej dyshimit të arsyeshëm se cilësia e mbrojtjes së tij është dëmtuar nga vendimi për refuzimin e ndihmës juridike, por është e mjaftueshme që ata të jenë në gjendje të ofrojnë tregues se prania e një avokati me përvojë do të ishte e nevojshme.<sup>79</sup>
53. Së fundmi, kur vlerëson gjendjen shoqërore dhe personale të të pandehurit, GJEDNJ-ja merr parasysh një numër faktorësh, siç është situata e punësimit,<sup>80</sup> e kaluara kriminale, kombësia, varësia nga droga, situata e varësisë etj.<sup>81</sup> Interesat e vlerësimit të drejtësisë tregojnë se ndihma ligjore falas mund të nevojitet për personat që konsiderohen të cenueshëm, si fëmijët, personat me probleme të shëndetit mendor dhe refugjatët.

Zdravko Stanev kundër Bullgarisë, nr. 32238/04, 6 nëntor 2012<sup>82</sup>

Aplikanti paraqiti një ankesë pranë GJEDNJ-së duke pretenduar se ishte shkelur e drejta e tij për një mbrojtje efektive dhe se atij iu ishte mohuar ndihma juridike. Aplikanti ishte dënuar për një vepër me gjobë prej 250 € dhe është urdhërua të paguajë 8,000 € si dëmshpërblim. Ai u ankua se ishte i papunë dhe nuk kishte të ardhura për të qenë në gjendje të përballonte punësimin e një avokati. Ai më tej u ankua se ishte në interes të drejtësisë që mbrojtja t'i ofrohej falas nga gjykata, sepse vepra me të cilën ishte akuzuar ishte serioze dhe përbënte një dënim me burgim deri në dy vjet. Së fundi, ai argumentoi se procedimet ishin mjaft të komplikuara dhe prandaj nevojitej që mbrojtja të ofrohej nga gjykata. Për të vendosur nëse ka pasur shkelje të nenit 6 (3) (c), GJEDNJ vlerësoi përputhshmërinë e faktorëve të lartpërmendur. Së pari, GJEDNJ konstatoi se duke pasur parasysh situatën e papunësisë së aplikantit, ishte e qartë se ai nuk kishte mjete të mjaftueshme. Së dyti, për të përcaktuar nëse ndihma juridike duhet të ishte dhënë në interes të drejtësisë, GJEDNJ vuri në dukje se aplikanti fillimisht ishte në rrezik të dënimit me burgim, që sipas praktikës së GJEDNJ-ishte mjaft serioze sa për të ofruar ndihmën juridike gjatë procedurës. Megjithëse nuk ishte i privuar nga liria, ai u dënua me detyrimin që të paguaj një gjobë dhe dëmshpërblimin, të cilat së bashku përbënin një sasi të konsiderueshme për shkak të gjendjes së tij të jo stabile financiare. Së treti, GJEDNJ-ja vuri në dukje se megjithëse aplikanti ishte arsimuar, ai nuk kishte trajnim të nevojshëm ligjor që do ti mundësonte të mbrohej në mënyrë efektive duke pasur parasysh kompleksitetin e procedurave, të cilat përfshinin çështje lidhur me rregullat mbi pranueshmërinë e provave, rregullat e procedurës dhe kuptimin e qëllimit. GJEDNJ-ja konstatoi që një avokat i kualifikuar pa dyshim do të ishte në gjendje të parashtronte çështjen me qartësi më të madhe dhe të kundërshtonte në mënyrë më efektive argumentet e ngritura nga

<sup>77</sup>Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar, 10 qershor 1996, paragrafët 60-61, Raportet e Aktvendimeve dhe Aktgjykimeve 1996-III.

<sup>78</sup>PhamHoang v. France, para 40.

<sup>79</sup>Artico v. Italy, 13 Maj 1980, par. 35, Seria A nr. 37.

<sup>80</sup>ZdravkoStanev.

<sup>81</sup>Quaranta, par. 35.

<sup>82</sup>ZdravkoStanev v. Bulgaria, nr. 32238/04, 6 nëntor 2012.

prokuroria. Prandaj, GJEDNJ konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 (3) (c) të KEDNJ-së.

54. Një numër i instrumenteve ndërkombëtare pranojnë se e drejta për ligjshmëri mund të vazhdojë të zbatohet gjatë fazës së apelit të procedurave penale, në interes të drejtësisë. Neni 15 i KNDCP-së garanton të drejtën e personave të dënuar që dënimi dhe dënimi të shqyrtohen "nga një gjykatë më e lartë sipas ligjit".<sup>83</sup> Në rastin *Maurice Thomas kundër Xhamajkës*, Komiteti i të Drejtave të Njeriut ('KDNJ') konstatoi se refuzimi i dhënies së ndihmës juridike për të pandehurin për të përgatitur një ankesë kundër dënimit në thelb ka mohuar të drejtën dhe mundësin e të pandehurit për të ushtruar mjetin e mëtejshëm juridik, duke shkelur nenin 14 (3) (d)<sup>84</sup> të KNDCP-së. Në të njëjtën mënyrë, GJEDNJ-ja vendosi që ndihma juridike duhet të jepet gjatë procedurave të apelit ku deri më tani është siguruar ndihma ligjore falas ngase kjo është në interes të drejtësisë, duke marrë parasysh "seriozitetin e çështjes në fjalë" dhe "natyrën e këtyre procedurave".<sup>85</sup>

### iii. Rekomandim

55. Direktiva shkon një hap përtej standardit të GJEDNJ-së kur përcakton nëse i dyshuari ose i akuzuari ka të drejtë për ndihmë juridike. Përderisa GJEDNJ kërkon vlerësimin të gjendjes financiare dhe të meritave, Direktiva, në përputhje me Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së, kërkon që autoritetet kompetente të japin ndihmë juridike pas vlerësimit të gjendjes financiare dhe të meritave, ose të dyja, varësisht nga praktikën e secilit Shtet Anëtar..

56. Megjithatë, Deklamimi 18 e lë atë në varësi të Shteteve Anëtare që të përcaktojnë masat praktike lidhur me ofrimin e ndihmës juridike. Marrëveshje të tilla do të kenë një ndikim të rëndësishëm në praktikë në aftësinë për të ushtruar efektivisht të drejtën për ndihmë juridike. Autoritetet kombëtare duhet të inkurajohen që të zbatojnë një proces që nuk do të ishte barrë tepër e rëndë për aplikantët, në mënyrë që ata të mos dekurajohen për të aplikuar për ndihmë juridike ose që ata që e kërkojnë atë më së shumti, si p.sh. personat e varfër, mund të mos kenë aftësinë praktike, për të aplikuar për ndihmë juridike.

### Pyetjet e para-transpozimit

A konsideroni se ka probleme të veçanta në lidhje me zbatimin e vlerësimit të gjendjes financiare dhe meritave në juridiksionin tuaj? Cilët janë shtytësit kryesor të këtyre problemeve?

A ka ndonjë problem lidhur me barrën e provës kur vendoset për kriteret e pranueshmerisë?

<sup>83</sup>KDNJ, *DouglasGentles dhe Kerr kundër Xhamajkës*, Komunikimi nr 352/1989, 1990, para. 11.2, shih linkun: <http://hrlibrary.umn.edu/undocs/html/vws352.htm>.

<sup>84</sup>KDNJ, *DamianThomas kundër Xhamajkës*, Komunikimi nr 800/1998, 26 maj 1999, para 6.4, available at <http://hrlibrary.umn.edu/undocs/session65/view800.htm>.

<sup>85</sup>*Maksimenko v. Ukraine*, nr. 39488/07, para 24, 20 dhjetor 2011.

Si mbulohen shpenzimet që lidhen me kërkesën për ndihmë juridike?

A nevojitem reforma legislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që Direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate në lidhje me vlerësimin e gjendjes financiare dhe të meritave? A ka ndonjë zgjidhje jo legislative për problemet që i shihni në praktikë lidhur me këtë aspekt?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me vlerësimin e gjendjes financiare dhe të meritave për të cilat mendoni se do të ishte e dobishme të adresohen në GJDBE për sqarime?

## D. Ndhima juridike në procedurat e urdhër arrestit evropian

### 1) Çfarë thotë Direktiva

57. Neni 5 i Direktivës trajton të drejtën për ndihmë juridike në procedurat e urdhër arrestit evropian. Ajo përcakton se personat e kërkuar kanë të drejtë për ndihmë juridike gjatë arrestimit derisa të dorëzohen, ose derisa vendimi për mos dorëzimin e tyre të bëhet i plotfuqishëm. Njëlloj, ndihma juridike duhet të vihet në dispozicion për personat e kërkuar, të cilët në ushtrimin e të drejtës së tyre për përfaqësim të dyfishtë në pajtim me Direktivën mbi të drejtën për të pasur Avokat, caktojnë një avokat në shtetin lëshues për të ndihmuar avokatin në shtetin ekzekutues.<sup>86</sup>
58. Sipas nenit 10 (4) dhe (5) të Direktivës mbi të drejtën për të pasur Avokat, autoriteti kompetent i një Shteti ekzekutues duhet pa vonesa të panevojshme të informojë individin e arrestuar në pajtim me urdhrin e arrestit evropian për të drejtën e tyre për të caktuar një avokat nga të dyja shtetet edhe nga shteti lëshues edhe nga ai ekzekutues. Nëse personi i kërkuar zgjedh të ushtrojë të drejtën e tij për përfaqësim ligjor në shtetin lëshues, autoriteti kompetent i shtetit ekzekutues duhet të mbajë lidhje me homologët e tij në shtetin lëshues, i cili duhet t'i japë personit të kërkuar informacionin e nevojshëm për të lehtësuar qasjen e tyre tek avokati.
59. Megjithëse Direktiva mbi të drejtën për qasje në avokat nuk rregullon të drejtën për ndihmë juridike me qëllim të sigurimit të përfaqësimit të dyfishtë në procedurën e urdhër arrestit evropian,<sup>87</sup>Neni 5 (2) i Direktivës përcakton qartë se personat e kërkuar kanë të drejtë për ndihmë juridike në Shtetin Anëtar lëshues për qëllime të ndjekjes penale në Shtetin Anëtar ekzekutues, për aq sa është e nevojshme ndihma juridike për të siguruar qasje efektive në drejtësi. Kjo do të ndodhte në rastin kur avokati në shtetin anëtar ekzekutues nuk mund të përmbushë detyrat e tij ose të saj në mënyrë efektive dhe efikase në lidhje me ekzekutimin e një urdhri të arrestit evropian pa ndihmën e një avokati në shtetin anëtar lëshues<sup>88</sup>. Në të kundërtën, Neni 5 nuk nënkupton një detyrim për Shtetet Anëtare për të ofruar ndihmë juridike për personin kundër të cilit është lëshuar urdhri i arrestit evropian kur personi i kërkuar kërkohet në shtetin ekzekutues vetëm për të mbajtur një dënim.
60. Roli i avokatit në shtetin anëtar lëshues është "të ndihmojë avokatin në shtetin anëtar ekzekutues, duke i ofruar informacione dhe këshilla me qëllim të ushtrimit efektiv të të drejtave të personave të kërkuar" sipas Vendimit Kornizë të Urdhër-arrestit Evropian<sup>89</sup>. Fair Trials identifikuan mënyrat e mundshme në të cilat avokati në shtetin lëshues mund të ndihmonte personin e kërkuar për të ushtruar një mbrojtje efektive në shtetin ekzekutues. Avokati në

<sup>86</sup>Neni 5(2) i Direktivës.

<sup>87</sup>Direktiva mbi të drejtën për të pasur avokat, Deklamimi 48

<sup>88</sup>Deklamimi 21.

<sup>89</sup>Vendimi Kuadër i Këshillit 2002/584 /JHA, i datës 13 qershor 2002 mbi urdhër-arrestin evropian dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet Shteteve Anëtare, Neni 11.



shtetin lëshues mund të jetë në gjendje të ofrojë informacion në lidhje me rastin e prokurorisë që ka të bëjë me procedurat e urdhër arrestit evropian; për të ofruar informacion në lidhje me sistemin e drejtësisë penale dhe ligjet e shtetit lëshues që ndihmon personin e kërkuar të kundërshtojë dorëzimin e tij/saj (d.m.th. informacion rreth kushteve të burgut dhe/ose këshilla mbi dispozitat ligjore vendore që ndikojnë në të drejtën e personit të kërkuar për një gjykim të drejtë, Neni 6 i KEDNJ); për të avokuar për tërheqjen e urdhër arrestit evropian dhe/ose duke lehtësuar alternativat e urdhër arrestit evropian; dhe të këshillojë për ndikimin e mundshëm të procedurave të personit të kërkuar të urdhër arrestit evropian në procedurat e tij penale.<sup>90</sup>

61. Paragrafi 3 i nenit 5 përcakton që Shtetet Anëtare mund të aplikojnë vlerësimin e gjendjes financiare në përputhje me Nenin 4 (3) (shih më tej) kur vendoset nëse do të jepet ndihmë juridike në kontekstin e procedurave të urdhër arrestit evropian.<sup>91</sup>

#### **Pyetjet e para-transpozimit**

A konsideroni se ka probleme të veçanta në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike në procedurat e urdhër arrestit evropian në juridiksionin tuaj? Cilët janë shtytësit kryesor të këtyre problemeve?

A është e njohur e drejta e përfaqësimit të dyfishtë në juridiksionin tuaj? A ekziston ndonjë mekanizëm në dispozicion për të siguruar që ndihma juridike të jetë në dispozicion të personit të kërkuar si në shtetin anëtar ekzekutues po ashtu edhe në shtetin anëtar lëshues?

A kërkohen reforma legislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që Direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike në procedurat e urdhër arrestit evropian ? A ka ndonjë zgjidhje jo legislative për problemet që i shihni në praktikë lidhur me këtë aspekt?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me ndihmën juridike në procedurat e urdhër arrestit evropian për të cilat mendoni se do të ishte e dobishme për t'ju adresuar GJDBE-së për sqarime?

### **E. Vendimmarrja për ndihmë juridike**

#### **i. Çfarë thotë Direktiva**

62. Në bazë të nenit 6 të Direktivës, autoritetet kompetente duhet të marrin vendime nëse do të lejojnë dhënien e ndihmës juridike dhe caktimin e avokatëve pa vonesa të panevojshme dhe në mënyrë të kujdesshme, duke respektuar të drejtat për mbrojtje. Vendimet për refuzimin e ndihmës juridike në tërësi ose pjesërisht duhet t'i njoftohen me shkrim personit që e ka kërkuar atë.<sup>92</sup>
63. Termi "autoritet kompetent" përkrahëhet në Deklamimin 24 si "një autoritet i pavarur që është kompetent për të marrë vendime në lidhje me dhënien e ndihmës juridike, dhe ose një gjykatë, duke përfshirë edhe një gjyqtar të vetëm." Deklamimi 24 konstaton se në disa situata urgjente mund të jetë e nevojshme që vendimi të merret nga policia ose prokuroria për të siguruar që ndihma juridike të ofrohet pa vonesa të panevojshme.

#### **ii. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale**

<sup>90</sup>Shihni FairTrials trajnime përmes internetit për "Rastet ndërkufitare dhe të drejtat e njeriut", shih linkun: <https://www.fairtrials.org/fair-trials-defenders/legal-training/online-training/cross-border-cases-and-human-rights-course-outline/>.

<sup>91</sup>Neni 5(3).

<sup>92</sup>Neni 6 (2).

64. Kërkesa për të njoftuar vendimin me shkrim rrjedh nga jurisprudenca e GJEDNJ-së që përcakton se vendimi për dhënien ose jo të ndihmës juridike nuk duhet të jetë arbitrar,<sup>93</sup>dhe duhet të përfshijë arsyet e refuzimit dhe të ofrohet brenda një kohe të mjaftueshme, në mënyrë që të mos privohet aplikanti nga e drejta për qasje në gjykata<sup>94</sup>.Autoriteti përgjegjës për vendosjen e dhënies së ndihmës juridike duhet të ofrojë "garanci thelbësore për t'i mbrojtur ata nga arbitrariteti."<sup>95</sup>Sipas GJEDNJ-së, një vendim për ndihmën juridike mund të konsiderohet arbitrar kur 1) vendimet për refuzimin e ndihmës juridike nuk mund të apelojnë; 2) ose kriteret e pranueshmerisë për ndihmën juridike janë të paqarta; 3) ose përbërja e autoritetit vendimmarrës ka të ngjarë të jetë e njëanshme.<sup>96</sup>

#### ***Tabor kundër Polonisë, nr. 12825/02, 27 qershor 2006***

Në këtë rast, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 kur një gjykatë rajonale në Poloni refuzoi të jepte ndihmë ligjore për aplikantin për qëllime të përfaqësimit ligjor në procedurat e kasacionit pa u mbështetur në ndonjë arsye për këtë refuzim. GJEDNJ konstatoi se megjithëse Gjykata Rajonale nuk ishte e detyruar të jepte ndonjë arsye për një refuzim të tillë sipas ligjit kombëtar, mos argumentimi me shkrim i këtij vendimi bëri që GJEDNJ-ja ta ketë të vështirë të kuptonte se cilat ishin rrethanat për të cilat Gjykata Rajonale kishte konsideruar se dhënia e ndihmës juridike nuk arsyetohej në rrethanat e rastit, i cili dukej se i plotësonte të gjitha kriteret e pranueshmerisë sipas ligjit kombëtar. Për më tepër, GJEDNJ-ja vuri në dukje se vendimi për refuzimin e ndihmës juridike ishte lëshuar një muaj pas skadimit të afatit të caktuar për paraqitjen e ankesës së kasacionit. Si rezultat, aplikanti mbeti pa ndonjë mundësi reale për të kërkuar ndihmë ligjore sipas zgjedhjes e tij për paraqitjen e një ankese të kasacionit, duke ua kujtuar se përfaqësimi ligjor profesional ishte i detyrueshëm. Prandaj, GJEDNJ-ja konstatoi se mënyra me të cilën gjykata përkatëse ka trajtuar kërkesën e aplikantit për ndihmë juridike nuk ishte në përputhje me kriteret për kujdes të duhur.

65. Për të siguruar gëzimin praktik dhe efektiv të së drejtës për ndihmë juridike, të gjithë të dyshuarit dhe personat e akuzuar duhet të informohen për një të drejtë të tillë në atë mënyrë që ata e kuptojnë plotësisht. Direktiva për të Drejtën e Informimit parashikon që të dyshuarit dhe personat e akuzuar duhet të njoftohen për çdo të drejtë për këshilla ligjore falas dhe kushtet për marrjen e këshillave të tilla, qoftë me gojë apo me shkrim<sup>97</sup>. Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së përcaktojnë se për të parandaluar arbitraritetin, kriteret e pranueshmerisë për shërbimet e ndihmës juridike, si dhe procedurën për të fituar qasje në to duhet të jenë në dispozicion të publikut dhe lehtësisht të arritshme nga të gjithë<sup>98</sup>.

66. Rekomandimi i Komisionit për Ndihmën Juridike përcakton detyrimin për të dhënë informacion mbi të drejtën për ndihmë juridike si dhe mjetet për t'iu qasur të dyshuarve ose personave të akuzuar dhe personave të kërkuar: "informata se si dhe ku të aplikojnë për një ndihmë të tillë, kriteret transparente kur një person ka të drejtë për ndihmë juridike, si dhe informata mbi mundësitë e ankimit në rrethanat ku refuzohet dhënia e ndihmës juridike ose kur avokati i ndihmës juridike nuk ofron ndihmë të mjaftueshme ligjore"<sup>99</sup>.

<sup>93</sup>[Tabor v. Poland](#), nr. 12825/02, para 44-46, 27 qershor 2006; [Wersel v. Poland](#), nr. 30358/04, par. 52-54, 13 shtator 2011.

<sup>94</sup>Ibid, par. 44-46.

<sup>95</sup>[Anghel v. Italy](#), nr. 5968/09, par. 51, 25 qershor 2013.

<sup>96</sup>[Santambrogio v. Italy](#), nr. 61945/00, par. 54-55, 21 shtator 2004.

<sup>97</sup>Direktiva 2012/13 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 dhe e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procedurën penale, neni 3 (1) (b).

<sup>98</sup>Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së, Udhëzimi 2.

<sup>99</sup>Rekomandimi i Komisionit i datës 27 nëntor 2013 mbi të drejtën për ndihmë juridike për të dyshuarit ose të akuzuarit në procedurën penale,

67. Lidhur me të drejtën për t'u njoftuar me vendimin e refuzimit të ndihmës juridike, Rekomandimi i Komisionit thotë se njoftimi duhet të bëhet menjëherë brenda një afati kohor që lejon të dyshuarit ose personat e akuzuar dhe personat e kërkuar që në mënyrë efektive dhe konkrete të përgatisin mbrojtjen e tyre<sup>100</sup>. Të dyshuarit ose personat e akuzuar dhe personat e kërkuar duhet të kenë të drejtën e shqyrtimit të vendimeve që kanë refuzuar kërkesat e tyre për ndihmë juridike në tërësi ose pjesërisht. Kjo dispozitë është në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila ka gjetur shkelje të nenit 6 (3) (c).

iii. Rekomandim

68. Autoritetet kombëtare duhet të marrin në konsideratë detyrimet e tyre sipas Direktivës mbi të Drejtën e Njoftimit 2012/13/EU dhe Rekomandimin e Komisionit për të drejtën e ndihmës juridike<sup>101</sup>, dhe të sigurojë që obligimi për njoftimin e personave mbi të drejtën e ndihmës juridike i plotëson standardet e përcaktuara në ato dispozita.

**Pyetjet e para-transpozimit**

A konsideroni se ka probleme të veçanta në lidhje me mënyrën se si merren vendimet për ndihmën juridike në juridiksionin tuaj? Cilat janë elementet kyçe të këtyre problemeve?

A përcakton ligji në juridiksionin tuaj kriteret se si duhet njoftuar aplikantin për vendimet në lidhje me ndihmën juridike?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me vendimmarrjen rreth ndihmës juridike për të cilët mendoni se do të ishte e dobishme t'ia adresonit GJDBE-së për sqarime?

**F. Cilësia e shërbimeve të ndihmës juridike dhe trajnimi**

1) Çfarë thotë Direktiva

69. Neni 7 trajton çështjen e mekanizmave mbi kontrollin e cilësisë për ndihmën juridike. Ai përcakton detyrimin që Shtetet Anëtare të ndërmarrin hapat e nevojshëm, duke përfshirë financimin, për të siguruar që sistemi i ndihmës juridike dhe shërbimet e ndërlidhura që do të ofrohen të jenë efektive dhe me cilësi adekuate me qellim sigurimin e procedurave korrekte, me respektin e duhur për pavarësinë e profesionit ligjor.

70. Neni 7 (2) parashikon gjithashtu që trajnimi adekuat duhet t'i ofrohet stafit të përfshirë në vendimmarrje rreth ndihmës juridike. Paragrafi 26 përcakton që "Shtetet Anëtare duhet të kërkojnë që ata që janë përgjegjës për trajnimin e gjyqtarëve të ofrojnë një trajnim të tillë për gjykatat dhe gjyqtarët që marrin vendime në lidhje me dhënien e ndihmës juridike. Përveç kësaj, trajnimi duhet t'u ofrohet avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dhe ata që përfitojnë nga ndihma juridike duhet të jenë në gjendje të zëvendësojnë avokatin e ndihmës juridike që u caktohet atyre, atëherë kur kjo të jetë e arsyeshme sipas rrethanave specifike.

ii. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale

Seksioni 2 (5).

<sup>100</sup>Rekomandimi i Komisionit i datës 27 nëntor 2013 mbi të drejtën për ndihmë juridike për të dyshuarit ose të akuzuarit në procedurën penale, Seksioni 2 (14).

<sup>101</sup>Rekomandimi i Komisionit Evropian 2013 / C378 / 03 të datës 27 nëntor 2013 mbi të drejtën për ndihmë juridike për të dyshuarit ose të akuzuarit në procedurën penale.

71. Raportuesja Speciale për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, Gabriela Knaul, në raportin e saj të vitit 2013, deklaroi se për ta konsideruar ndihmën juridike të jetë efektive, ajo duhet të përfshijë, por jo të jetë e kufizuar në, qasjen e papenguar në ofrimin e ndihmës juridike, konfidencialitetin e komunikimeve, qasjen në informata dhe shkresat e lëndës, kohën e mjaftueshme dhe lehtësira të duhura në përgatitjen e rasteve ligjore, si dhe ofrimin e këshillave dhe edukimit ligjor dhe mekanizmave alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.<sup>102</sup>
72. Efektshmëria e ndihmës juridike duhet të sigurohet më tej përmes “institucionalizimit të shërbimeve në mënyrë që ofrimi i tyre të mund të vlerësohet, organizohet dhe monitorohet. Për më tepër, ofruesit e ndihmës juridike duhet të mbahen përgjegjës për shërbimet që ata ofrojnë si një mjet për të siguruar cilësinë e këshillave ligjore, mbrojtjes dhe përfaqësimit, si dhe qasjen e duhur dhe adekuate në sistemin gjyqësor”<sup>103</sup>. Në këtë drejtim, Rekomandimi i Komisionit për Ndhimën Ligjore i vitit 2013 përcakton që Shtetet Anëtare duhet të vendosin sisteme ose mekanizma mbi kontrollin e cilësisë për të siguruar cilësinë e avokateve që japin ndihmën juridike dhe për të lejuar autoritetet kompetente të zëvendësojnë avokatet që japin ndihmën juridike ose të kërkojnë nga ata të përmbushin detyrimet e tyre, nëse këta avokatë dështojnë të ofrojnë ndihmën ligjore adekuate<sup>104</sup>.
73. Shtetet Anëtare inkurajohen, sipas Rekomandimit të vitit 2013, të sigurojnë që stafi i përfshirë në vendimmarrje për ndihmë juridike dhe avokatët që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike në procedurat penale të marrin trajnim të përshtatshëm për të siguruar një kualitet të lartë të këshillave dhe ndihmës juridike. Veçanërisht, përderisa Rekomandimi inkurajon që akreditimi i avokatëve për ndihmë juridike për aq sa të jetë e mundur, të lidhet me një detyrim për t'u nënshtruar trajnimeve të vazhdueshme profesionale, Raportuesja Speciale rekomandon që Shtetet të kërkojnë përfundimin e kualifikimeve minimale dhe trajnime për profesionistët dhe paralegalët që punojnë në sistemin e ndihmës juridike<sup>105</sup>.
74. Raportuesja Speciale në raportin e saj deklaroi se në mënyrë që ndihma juridike të jetë efektive, shteteve anëtare do tu kërkohej të bënin dispozita të duhura buxhetore për shërbimet e ndihmës juridike për të siguruar se janë përmbushur standardet e cilësisë<sup>106</sup>. Në mënyrë të veçantë, Udhëzimi 12 i Parimeve dhe Udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara mbi Qasjen në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale rekomandon që shtetet anëtare të marrin të gjitha masat e duhura për të krijuar një fond të ndihmës ligjore, për të financuar skemat e ndihmës juridike, për të mbështetur ofrimin e ndihmës juridike nga shoqatat ligjore ose odat e avokatëve, për të mbështetur klinikat universitare dhe sponsorizimin e organizatave joqeveritare dhe organizatave të tjera, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në të gjithë vendin. Njëlloj, fondet e ndara për të dyshuarit ose personat e akuzuar duhet t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen efektive, siç janë kopjimi i dosjeve dhe dokumenteve përkatëse, mbledhja e provave, shpenzimet lidhur me dëshmitarët ekspertë, ekspertët mjeko-ligjorë dhe punonjësit socialë . Pagesat duhet të bëhen në kohë<sup>107</sup>.

<sup>102</sup>Raportuesja speciale për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, Gabriela Knaul, Raporti i vitit 2013 për ndihmën juridike, seanca e 23-të e KDNJ, A/KDNJ/23/43, par. 41, shih linkun: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G13/119/35/PDF/G1311935.pdf?OpenElement>.

<sup>103</sup>Ibid, par. 42.

<sup>104</sup>Rekomandimi i Komisionit të BE-së 2013 / C378 / 03 të datës 27 nëntor 2013 mbi të drejtën e ndihmës juridike për të dyshuarit ose të akuzuarit në procedurën penale, Seksioni 3.

<sup>105</sup>Ibid

<sup>106</sup>Raportuesja speciale për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, Gabriela Knaul, Raporti i vitit 2013 për ndihmën juridike, seanca e 23-të e KDNJ, A/KDNJ/23/43, para 73, shih linkun: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G13/119/35/PDF/G1311935.pdf?OpenElement>.

<sup>107</sup>Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së, Udhëzimi 12.

75. Kompensimi i ulët i avokatëve të ndihmës juridike në të gjitha Shtetet Anëtare është identifikuar nga anëtarët e LEAP si një nga arsyet kryesore për cilësinë e përgjithshme të pakënaqshme të shërbimeve të ndihmës juridike në të gjithë BE-në. Siç është theksuar në dokumentin mbi qëndrimin e FairTrials, shpërblimi i ofruar për avokatët e ndihmës juridike duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar që të drejtat e personit të dyshuar ose të akuzuar të mos komprometohen thjesht për shakë të pamundësisë për të paguar një përfaqësim ligjor privat dhe BE-ja duhet të nxjerrë ligje në përputhje me rrethanat<sup>108</sup>.

Anëtarët e LEAP-it kanë raportuar që në shumë vende të BE-së shpërblimi për avokatët e ndihmës juridike është shumë i ulët (50% ose më i vogël sesa ai që do të fitonte një avokat i punësuar privatisht me orë) ose do të vlerësohej si një normë fikse pa marrë parasysh kompleksitetin e rastit apo gamën e plotë të shpenzimeve (p.sh. duke përfshirë kostot e udhëtimit dhe tarifat për kohën e pritjes në gjykatë dhe në stacionin policor). Anëtarët e LEAP raportojnë se shkalla fikse për disa raste është aq e ulët sa që avokatët e ndihmës juridike në përgjithësi dalin me një humbje neto. Përveç kësaj, nivelet e shpërblimit për punën e ndihmës juridike në përgjithësi nuk marrin parasysh rëndësinë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional që shpesh kërkon pjesëmarrje në programe të kushtueshme të trajnimit. Për shembull:

- ➔ Në Lituani, në vitin 2014, avokatët e ndihmës juridike fitonin 11,58 euro në orë para tatimit, dhe ekzistonte një limit se sa orë mund të faturoheshin në faza të caktuara të procedurës penale. Megjithatë pagat janë rritur pak që nga ajo kohë, normat vazhdojnë të jenë të pakënaqshme.
- ➔ Në Holandë, tarifa mesatare është rreth 100 euro/në orë kur viziton një klient në stacionin policor. Norma mesatare për avokatët privat është ndërmjet 250 dhe 300 euro/në orë. Kjo skemë ka dy ndërrime në ditë (nga ora 7 deri në 13:30 dhe nga ora 13:30 deri në orën 20). Avokati kujdestar mbulon një ndërrim në çdo dy muaj.
- ➔ Në Qipro, avokatët paguhën në shuma minimale dhe shpesh kanë vonesa të mëdha në pagesa. Gjithashtu, avokati shpesh nuk paguhet për shërbimet e ofruara para fillimit të gjyqimit sepse nëpunësi i gjykatës i llogarit shpenzimet vetëm nga koha kur fillon procedura para Gjykatës.

76. KDNJ rekomandon që “ndihma juridike duhet të mundësojë këshillën për të përgatitur mbrojtjen e klientit të tij në rrethana që mund të sigurojnë drejtësi, të cilat përfshijnë, sigurimin e shpërblimit adekuat për ndihmë juridike<sup>109</sup>. Edhe nën-komiteti i OKB-së për Parandalimin e Torturës dhe KPT-ja kanë theksuar shqetësime të shumta rreth organeve të ndihmës juridike kombëtare që kanë mungesë të kuadrit dhe resurseve. Ata të dy kanë theksuar se tarifat e ulëta për shërbimet kanë një efekt dekurajues mbi avokatët e ndihmës juridike, pasi ato krijojnë një ngarkesë të tepruar pune që nuk është në përputhje me mbrojtjen efektive të interesave të personave të privuar nga liria<sup>110</sup>.

#### iv. Rekomandimet

77. Ne mbështesim rekomandimin tonë të bërë në lidhje me projekt-Direktivën që autoritetet kombëtare, gjatë transpozimit dhe zbatimit të Direktivës, duhet t'i kushtojnë vëmendje të duhur kostove të shkaktuara nga avokatët e ndihmës juridike mbi tarifat për orët specifike gjatë kohës

<sup>108</sup>Dokumenti mbi qëndrimin, 13.

<sup>109</sup>KDNJ, Komunikata nr. 250/1987, Carlton Reid kundër Xhamajkës, par. 13

<sup>110</sup>Raporti Vjetor i Pestë për SPT që mbulon periudhën janar-dhjetor 2011, 19 mars 2012, UN Doc CAT/C/48.3, par. 79, shih linkun:

[http://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/opcat/docs/CAT-C-48-3\\_en.pdf](http://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/opcat/docs/CAT-C-48-3_en.pdf); See also Raport mbi vizitën në Kroaci të kryer nga KPT-ja nga 1 deri më 9 dhjetor 2003, CPT / Inf (2007), paragrafi 24, shih linkun: <http://www.cpt.coe.int/documents/hrv/2007-15-inf-eng.pdf>; Raport mbi vizitën në Kroaci të kryer nga KPT-ja nga 4 deri më 14 maj 2007, KPT / Inf (2008), paragrafi 19, shih linkun: <http://www.cpt.coe.int/documents/hrv/2008-29-inf-en.pdf> Raport mbi vizitën në Hungari të kryer nga KPT-ja nga 5 deri më 16 dhjetor 1999, CPT/Inf (2001), para 32, shih linkun: <http://www.cpt.coe.int/documents/hun/2001-02-inf-eng.pdf>; Raport mbi vizitën në Hungari të kryera nga KPT nga 30 mars deri më 8 prill 2005, CPT / Inf (2006), par. 23, shih linkun: at <http://www.cpt.coe.int/documents/hun/2006-20-inf-eng.pdf>; Raport mbi vizitën në Poloni të kryer nga KPT-ja nga 4 deri më 15 tetor 2004, CPT / Inf (2006) par. 21, shih linkun: <http://www.cpt.coe.int/documents/hun/2006-20-inf-eng.pdf>.

kur ata takohen ose përfaqësojnë personat e dyshuar ose të akuzuar, duke përfshirë tarifën për kohët e pritjes, shpenzimet e udhëtimit dhe tarifën e trajnimit.

78. Për më tepër, ne rekomandojmë që çdo regjim tarifash fikse për përfaqësuesit e ndihmës juridike të përfshijë fleksibilitet të mjaftueshëm për të lejuar rritjen e tarifës aty ku është e nevojshme për të reflektuar kompleksitetin dhe/ose kohëzgjatjen e një rasti të veçantë.<sup>111</sup>

**Pyetjet e para-transpozimit**

A konsideroni se ka probleme të veçanta në lidhje me kualitetin e ndihmës juridike në juridiksionin tuaj? Cilat janë elementet kyçe të këtyre problemeve?

A kërkohet reforma legjislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që Direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate në lidhje me cilësinë e sistemit të ndihmës juridike dhe shërbimeve të ndihmës juridike? A ka ndonjë zgjidhje jo legjislative për problemet që shihni në praktikë lidhur me këtë aspekt?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me kualitetin e ndihmës juridike për të cilën mendoni se do të ishte e dobishme t'ia adresonit GJDBE-së për sqarime?

---

<sup>111</sup>Dokumenti mbi Qëndrimet e FairTrials, 14

## G. Mjetet juridike për shkeljet e së drejtës në ndihmë juridike

### i. Çfarë thotë Direktiva

79. Neni 8 kërkon nga Shtetet Anëtare të sigurojnë që mjetet juridike janë në dispozicion sipas ligjit kombëtar kur e drejta për ndihmë juridike sipas Direktivës të jetë shkelur<sup>112</sup>. Deklamimi 27 thekson se një "mjet juridik efektiv duhet të jetë në dispozicion kur dëmtohet e drejta për ndihmë juridike ose kur vonohet ose refuzohet plotësisht ose pjesërisht ofrimi i ndihmës juridike."<sup>113</sup>

80. Ngjashëm sikur në secilën prej Direktivave të mëparshme udhërrëfyese, kjo Direktivë nuk arrin të shpjegojë se si Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të drejtat e mbrojtjes dhe rregullshmëria e procedimeve të mbrohen nëpërmjet një mjeti adekuat juridik, duke e lënë këtë çështje nën diskrecionin e Shteteve Anëtare për të vendosur se cili duhet të jetë mjeti i duhur juridik.

### ii. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale

81. Siç theksohet në dokumentin mbi qëndrimin e Fair Trials, duhet të ketë standarde minimale në lidhje me mjetet juridike kur ofrimi i ndihmës juridike "dëmtohet, vonohet ose refuzohet, ose nëse personat nuk janë informuar në mënyrë adekuate mbi të drejtën e tyre për ndihmë juridike", siç përcaktohet në Parimin 9 të Parimeve dhe Udhëzuesve të OKB-së. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë mjetet juridike për situatat në të cilat shpjegimet rreth përshtatshmërisë ose dispozitave të kthimit të kostove janë të paqarta ose të portretizuara në mënyra që kanë tendencë të nxisin heqjen dorë nga e drejta për të pasur avokat.<sup>114</sup>

82. Sipas Parimeve dhe Udhëzuesve të OKB-së, masat e tilla juridike mund të përfshijnë ndalimin e ndërmarjes së veprimeve procedurale, lirimin nga paraburgimi, përjashtimin e provave, shqyrtimin gjyqësor dhe kompensimin<sup>115</sup>. Në këtë drejtim, GJEDNJ ka konsideruar vazhdimisht se forma më e përshtatshme e kompensimit për një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë është që të sigurohet që të dyshuarit ose personat e akuzuar, për aq sa është e mundur, të vihen në pozita të tilla në të cilat do të ishin nëse të drejtat e tyre nuk do ishin shpërfillur.<sup>116</sup> Sidoqoftë, kjo qasje përmirësuese është e destinuar të ndryshojë varësisht nga natyra e shkeljes në fjalë, fazës së procedurës në të cilën është identifikuar shkelja dhe rezultatit të procedurës.

83. Sa i përket natyrës së shkeljes, dështimit ose vonesës në dhënien e ndihmës juridike para ose gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë, që e çon të dyshuarin ose të akuzuarin në dhënien e deklaratave inkriminuese, mund të kërkojë një mjet juridik krejtësisht të ndryshëm nga ai që kërkohet për mos dhënien e ndihmës juridike gjatë gjykimit të të akuzuarit.

84. Sa i përket shkeljeve të së drejtës për ndihmë juridike gjatë fazës së hetimit paraprak, duke pasur parasysh se e drejta për ndihmë juridike sipas Direktivës është njohur për të siguruar

<sup>112</sup>Neni 8.

<sup>113</sup>Deklamimi 27

<sup>114</sup>FairTrials& LEAP, Vëzhgimet fillestare mbi draft raportin e Parlamentit Evropian për Direktivën e Propozuar mbi Ndihmën Juridike, dhjetor 2014.

<sup>115</sup>Parimet dhe Udhëzuesit e OKB-së.

<sup>116</sup>*Salduz v Turkey*[GC], nr. 36391/02, KEDNJ 2008.

efektivitetin e së drejtës për përfaqësim nga avokati, siç parashikohet në Direktivën mbi të drejtën për të pasur avokat, një shkelje e tillë do të kërkonte përjashtimin e çdo prove të dhënë në mungesë të avokatit sipas doktrinës së *Salduzit*.<sup>117</sup>

85. Sa i përket shkeljeve të së drejtës për ndihmë juridike gjatë procesit gjyqësor, mosdhënia e ndihmës juridike gjatë gjykimit mund të çojë të akuzuarin që të vendosë të përfaqësojë veten, gjë që më pas mund të rezultojë në dënim. Një mjet i përshtatshëm juridik në këtë rast mund të jetë urdhërimi i rigjykimit. Për më tepër, mosdhënia e ndihmës juridike në përgatitjen e një seance dëgjimore, mund të çojë që të dyshuarit ose të akuzuarit të urdhërohen të qëndrojnë në paraburgim për periudha të zgjatura kohore. Një zgjidhje e përshtatshme në këtë situatë mund të jetë lirimi i të dyshuarit nga paraburgimi.
86. Faza në të cilën ndodh shkelja duhet gjithashtu të përcaktoj llojin e mjetit juridik që është i përshtatshëm për shkeljet e së drejtës për ndihmë juridike. Për shembull, shkelja e së drejtës për ndihmë juridike në fazat e paraburgimit mund të ketë pasoja të ndryshme gjatë procesit të gjykimit ose apelimit. Sa më herët që zbulohet një shkelje e Nenit 6(3)(c) të KEDNJ-së, aq më shumë ka gjasa të ofrohet një mjet efektiv juridik brenda rrjedhës së hetimit dhe gjykimit.
87. Në këtë drejtim, është e dobishme të theksohet se Gjykata e Drejtësisë e BE-së ('**GJDBE**') ka përcaktuar qartë parimin e se Drejtës së BE-së për "mbrojtjen efektive gjyqësore të të drejtave individuale sipas të drejtës së BE", i cili kërkon jo vetëm nga GJDBE por edhe nga gjykatat kombëtare së bashku të sigurojnë një mjet efektiv juridik dhe një gjykim të drejtë kur shkelen të drejtat, duke iu referuar drejtpërdrejtë Nenit 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së ('**KDTH**') mbi të drejtën për një mjet efektiv juridik dhe për një gjykim të drejtë.<sup>118</sup>

Në rastin C-64/16 të *Associação Sindical dos Juizes Portugueses*<sup>119</sup>, parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore të të drejtave të individëve sipas të Drejtës së BE-së, i mishëruar në Nenin 19 të Traktatit të Bashkimit Evropian (**TBE**), jep shprehjen konkrete për vlerën e sundimit të ligjit të përmendur në Nenin 2 TBE, duke ia besuar përgjegjësinë për të siguruar shqyrtimin gjyqësor në rendin juridik të BE jo vetëm për Gjykatën e Drejtësisë, por edhe për gjykatat dhe tribunalet kombëtare. Në këtë drejtim, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë mjete juridike të mjaftueshme për të siguruar mbrojtje efektive gjyqësore për palët individuale në fushat e mbuluara nga e drejta e BE-së (duke përfshirë këtu edhe drejtësinë penale): "ekzistenca e një shqyrtimi efektiv gjyqësor të hartuar për të siguruar pajtueshmërinë me të drejtën e BE-së është thelbi i sundimit të ligjit [...]"<sup>120</sup>

<sup>117</sup>Shihni Direktivën mbi të drejtën për të pasur avokat, Manuali i Praktikuesve, të disponueshme në faqen e internetit:

<https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/A2L-Toolkit-FINAL.pdf>

<sup>118</sup>Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, C 326/39, 26 tetor 2012, Neni 47, e disponueshme në <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:12012P/TXT&from=EN>.

<sup>119</sup>Rasti C-64/16, *Associação Sindical dos Juizes Portugueses*, 27 shkurt 2018, [EU:C:2018:117](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:62016CJ0064&from=EN).

<sup>120</sup>Ibid, paragrafi 36.



88. Me qëllim që të vendosim se cili është një mjet i përshtatshëm për shkelje të ndryshme të së drejtës për ndihmë juridike, i referohemi manualeve tona të mëparshme për praktikues mbi "Përdorimin e së drejtës së BE-së në praktikën penale"<sup>121</sup>dhe në "Direktivën mbi të drejtën për të pasur avokat".<sup>122</sup> Fair Trials mbështetet në supozimet e mëposhtme në këto Manuale, të cilat janë gjithashtu relevante në kontekstin e Direktivës së analizuar në këtë Manual:

- Përderisa dispozitat në direktivat specifike ndryshojnë në shkallën e përafrimit që ato sjellin, të gjitha pasqyrojnë supozimin e përgjithshëm se të drejtat e BE-së duhet të mbrohen në mënyrë efektive përmes mjeteve juridike gjyqësore.
- Për të qenë ligjërishit efektiv, një mjet juridik i ofruar në lidhje me shkeljen e njërës prej Direktivave duhet të jetë i atillë që të arrijë qëllimin e ndjekur, i cili në të gjitha Direktivat është të sigurojë rregullshmërinë e procedurës.
- Prandaj, mjeti juridik që duhet të kërkoni është ai në kontekstin e procedurës penale, e cili e ka aftësinë për të njohur një akt të caktuar (p.sh. marrja në pyetje nga policia është zhvilluar në kundërshtim me detyrimet e Direktivave) si të papajtueshme me të drejtën sipas Direktivave dhe të ndërmarrin veprime për të korrigjuar çfarëdo paragjykimi që kjo ka shkaktuar në drejtësinë e procedurës.

#### **Pyetjet para transpozimit**

Çfarë mjete juridike, nëse ka ndonjë, ekzistojnë në ligjin për shkeljen e së drejtës për ndihmë juridike në juridiksionin tuaj?

A kanë këto mjete juridike efektin e vënies së të dyshuarit ose personit të akuzuar në pozicionin në të cilin do të kishin qenë, nëse të drejtat e tyre nuk do të shpërfillëshin?

A konsideroni se ka probleme të veçanta në lidhje me mjetet juridike për shkeljet e së drejtës për ndihmë juridike në juridiksionin tuaj? Cilat janë nxitësit kryesorë të këtyre problemeve?

A kërkohet reformë legislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që Direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate në lidhje me të drejtat në mjete juridike? A ekzistojnë zgjidhje tjera jo legislative për problemet që i hasni në praktikë?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me të drejtën për një mjet juridik për shkeljet e së drejtës për ndihmë juridike për të cilën mendoni se mund të kërkohet në mënyrë të dobishme nga GJED për të siguruar qartësi?

<sup>121</sup>FairTrials, Manuali 'Përdorimi i së drejtës së BE-së në praktikën penale', 2015, fq. 8-9, i disponueshëm në <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/Using-EU-law-A2L-FINAL1.pdf>.

<sup>122</sup>FairTrials, 'Mjeti i Udhërrëfyesit për Praktikues; Direktiva mbi të drejtën për të pas avokat', 2016, i disponueshëm në <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/A2L-Toolkit-FINAL.pdf>.

## H. Ndhimja juridike për të dyshuarit e cenueshëm

### i. Çfarë thotë Direktiva

89. Neni 9 i Direktivës kërkon që Shtetet Anëtare, gjatë zbatimit të Direktivës, të marrin në konsideratë nevojat e veçanta të dyshuarve të cenueshëm, personave të akuzuar dhe personave të kërkuar.
90. Për më tepër, Direktiva thuhet se zbatohet për të dyshuarit, personat e akuzuar dhe personat e kërkuar pavarësisht nga statusi i tyre juridik, shtetësia ose kombësia. Prandaj, Shtetet Anëtare duhet të respektojnë dhe garantojnë të drejtat e përcaktuara në Direktivë pa asnjë diskriminim të bazuar në ndonjë arsye të tillë si raca, ngjyra, gjinia, orientimi seksual, gjuha, feja, mendimi politik ose tjetër, kombësia, origjina etnike ose shoqërore, prona, aftësia e kufizuar ose lindja.<sup>123</sup>

### ii. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale

91. Gjatë transpozimit të Direktivës, Shtetet Anëtare duhet të kenë kujdes të duhur për nevojat e veçanta të të dyshuarve të cenueshëm sipas të drejtës së BE-së, KEDNJ-së dhe standardeve të tjera relevante ndërkombëtare, duke përfshirë Parimet dhe Udhëzuesit e OKB-së, të cilat parashikojnë dispozita specifike për gratë, fëmijët dhe grupet me nevoja të veçanta.
92. Sipas Rekomandimit të Komisionit të BE-së për vitin 2013 mbi masat mbrojtëse të të dyshuarve të cenueshëm '**Rekomandimi për të Dyshuarit e Cenueshëm**'), Shtetet Anëtare inkurajohen të forcojnë të drejtat procedurale të të gjithë të dyshuarve ose personave të akuzuar të cilët nuk janë në gjendje të kuptojnë dhe të marrin pjesë në mënyrë efektive në procedura penale për shkak të moshës, gjendjes së tyre mendore ose fizike ose për shkak të aftësive të tyre të kufizuara. Kjo ka rëndësi të veçantë sa i përket të drejtës për tu informuar dhe të drejtës për informim në lidhje me ndihmën juridike, si dhe të drejtën për të pasur avokat.
93. Sipas Direktivës mbi të drejtën për të pasur avokat, të dyshuarit ose personat e akuzuar mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për të pas avokat, në të cilin rast, siç u diskutua më lart, ata nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga e drejta për ndihmë juridike sipas kësaj Direktive. Megjithatë, sipas Rekomandimit të të Dyshuarve të Cenueshëm, Shtetet Anëtare nuk duhet t'u lejojnë personave të cenueshëm që të heqin dorë nga e drejta e tyre për të pas avokat. Prandaj, sapo të identifikohet cenueshmëria, ndihma juridike duhet të jepet automatikisht në interes të drejtësisë. Kjo është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në rastin *Biba v. Greqisë* ka gjetur se kompleksiteti i procedurës, së bashku me faktin se aplikanti ka qenë një shtetas i huaj i cili nuk fliste greqisht apo nuk e njeh sistemin gjyqësor grek, nënkuptonte se "interesat e drejtësisë" kërkonin dhënien e ndihmës juridike.<sup>124</sup> Më së paku, në mënyrë që të vlerësohet validiteti i heqjes dorë nga e drejta për avokat nga një i dyshuar i cenueshëm duhet të aplikohet i njëjti nivel i shqyrtimit sikurse në rastet që përfshijnë fëmijë të cenueshëm.

<sup>123</sup>Deklamim 29.

<sup>124</sup>[Biba v. Greece](#), nr. 33170/96, 26 shtator 2000, paragrafi 29.

94. Kur i jepen informacione një personi të cënueshëm për ndihmën juridike ose kur ata njoftohen për një vendim mbi ndihmën juridike, duhet t'i kushtohet vëmendje Rekomandimit për të Dyshuarit e Cënueshëm, e cila kërkon që informacionet e përmendura t'i jepen edhe një "të rrituri adekuat dhe/ose një përfaqësuesi ligjor" të propozuar nga personi i cënueshëm ose nga autoritetet kompetente për të ndihmuar atë person, i cili gjithashtu duhet të jetë i pranishëm në stacionin policor dhe gjatë seancave dëgjimore të gjykatës.<sup>125</sup>

#### **Pyetjet para transpozimit**

Deri në çfarë mase është zbatuar Rekomandimi për të Dyshuarit e Cënueshëm në juridiksionin tuaj?

A kërkohet reformë legislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që Direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate në lidhje me të dyshuarit e cënueshëm? A ekzistojnë zgjidhje tjetër jo legislative për problemet që i hasni në praktikë?

Si identifikohet cënueshmëria në praktikë, dhe nga kush?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me të drejtën për një mjet juridik për shkeljet e së drejtës për ndihmë juridike për të cilën mendoni se mund të kërkohet në mënyrë të dobishme nga GJDBE për të siguruar qartësi?

## **VI. PËRDORIMI I DIREKTIVËS PARA AFATIT TË TRANSPOZIMIT TË SAJ**

95. Direktiva ka hyrë në fuqi më 14 nëntor të vitit 2016 (njëzet ditë pas datës së publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të BE-së). Sidoqoftë, në kohën e publikimit të këtij Manuali, afati përfundimtar për transpozim në ligjin kombëtar (25 maj 2019) është ende larg. Si e tillë, Direktiva ende nuk është e detyrueshme për Shtetet Anëtare dhe e zbatueshme përmes parimit të së drejtës së BE-së me efekt të drejtpërdrejtë në gjykatat kombëtare.
96. Megjithatë, në këtë seksion ne shpjegojmë se si Direktiva mund të ketë ende efekt ligjor në kontekstin kombëtar gjatë periudhës para-transpozimit. Ne shqyrtojmë më poshtë disa jurisprudenca përkatëse përpara se të paraqesim shembuj nga tri Shtete Anëtare në të cilat janë përdorur Direktivat e Udhërrëfyesit në proceset gjyqësore, siç mund të dëshironi të bëni me Direktivën.

### **A. Jurisprudenca e GJED-së**

97. GJED ka konfirmuar se megjithëse Direktivat nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë para afatit të transpozimit, ato nuk janë plotësisht pa efekt para kësaj kohe. Në *Kolpinguis*,<sup>126</sup> Gjykata e Drejtësisë së BE konfirmoi se detyra e përputhjes së interpretimit mund të fillonte pas miratimit të një Direktive dhe nuk ka qenë domosdoshmërishtë kontingjente me përmbushjen e afatit të

<sup>125</sup>Rekomandimi mbi të Dyshuarit e Cënueshëm, paragrafët 8 -10.

<sup>126</sup>Rasti 80/86 *KolpinguisNijmegen*, [ECLI:EU:C:1987:431](https://eur-lex.europa.eu/eli/cj/1987/431).

transpozimit. Në *Wallonie*,<sup>127</sup> GJDBBE është pyetur nëse Shtetet Anëtare ishin të përjashtuara nga miratimi i masave në kundërshtim me Direktivën gjatë periudhës së parashikuar për transpozimin e saj. GJED ka theksuar se:

- Gjatë periudhës së transpozimit, Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që rezultati i përcaktuar nga Direktiva të arrihet në fund të asaj periudhe.
- Gjatë kësaj periudhe ata duhet të përmbahen nga marrja e masave të cilat mund të rrezikojnë seriozisht rezultatin e parashikuar.

98. Këto baza të njëjta u zbatuan në rastet e mëvonshme duke zhvilluar *parimin Wallonie*, përfshirë rastin e *Adelener*,<sup>128</sup> e cila ngriti çështjen e rolit të gjykatave në interpretimin e legjislacionit para afatit të zbatimit. GJDBE theksoi se:

- Duke pasur parasysh se të gjitha autoritetet e Shteteve Anëtare i nënshtrohen detyrimit për të siguruar që dispozitat e ligjit të Komunitetit të marrin efekt të plotë, detyrimi për të mos marrë masa që mund të rrezikojë objektivin e një Direktive, zbatohet edhe në gjykatat kombëtare.
- Nga data kur një Direktivë ka hyrë në fuqi, gjykatat e Shteteve Anëtare duhet të përmbahen sa më shumë që është e mundur nga interpretimi i ligjit vendor në atë mënyrë që të mund të komprometojë seriozisht, pas skadimit të periudhës së transpozimit, arritjen e objektivit të ndjekur me atë Direktivë.

99. Në rastin *Mangold*,<sup>129</sup> GJDBE ka nxjerrë një vendim i cili konsiderohet si kontrovers. GJDBE konstatoi se kur një Direktivë parasheh një artikullim më të hollësishëm të një parimi, i cili tashmë është vendosur në të drejtën e BE-së (në rastin e *Mangold*, ky ishte parimi i mos-diskriminimit në bazë të moshës), atëherë parimi i së drejtës së BE-së duhet të miratohet pa marrë parasysh nëse ka kaluar afati i transpozimit të Direktivës në fjalë. Duke pasur parasysh se Direktiva jep udhëzime të hollësishme për Shtetet Anëtare për zbatimin e një të drejte themelore tashmë të mbrojtur në Nenin 48 të Kartës së BE-së për Liritë Themelore, atëherë mund të aplikohet një qasje e ngjashme.

## **B. Disa ide para përfundimit të afatit**

100. Ne mendojmë se realisht do të jetë sfiduese të arrihen rezultate pozitive mbi bazën e Direktivës përpara afatit të transpozimit (e njëjta gjë vlen edhe për direktivat e tjera që në kohën e duhur mund të miratohen më tej për Udhërrëfyesin). Më poshtë ne propozojmë disa argumente, edhe pse mund të themi qartë se disa prej tyre janë shumë të gjera.

### ***Argumente të bazuara në doktrinën e Wallonie***

☐ Autoritetet kombëtare, si ato hetuese ashtu edhe gjykatat, janë të detyruara nga obligimi i artikulluar në Nenin 4(3) të TBE-së për të “ndërmarrë çfarëdo mase të përshtatshme, të përgjithshme ose të veçantë, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet”, që përfshin Direktivën. Obligimet sipas Nenit 288 për të arritur objektivat e kësaj

<sup>127</sup>Rasti C-129/96 *Inter-EnvironnementWallonie ASBL v Région wallonne* (ECLI:EU:C:1997:216).

<sup>128</sup>Rasti C-212/04 *Adeneler* (ECLI:EU:C:2006:443).

<sup>129</sup>Rasti C-144/04 *Werner Mangold v Rüdiger Helm* (ECLI:EU:C:2005:709).

Direktive tashmë janë krijuar duke u nisur nga ajo masë që hyn në fuqi.

☒ Duke u mbështetur në *Kolpinguis*, detyra e gjykatave kombëtare për të interpretuar legjislacionin kombëtar në përputhje me një direktivë lind para afatit të fundit për transpozim të direktivës, kështu që nëse ligji kombëtar mund të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Direktivën, atëherë kjo duhet të bëhet.

☒ Në mënyrë më të qartë përcaktohet detyrimi i Shtetit Anëtar që të përmbahet nga marrja e masave, para afatit të transpozimit të një Direktive, që mund të rrezikojnë seriozisht arritjen e objektivave të kësaj të fundit pas këtij afati (*Wallonie*). Kjo përfshin gjykatat, të cilat janë të detyruara të përmbahen nga miratimi i interpretimeve të së drejtës kombëtare në këtë periudhë, që do të thotë se rezultatet nuk do të arriheshin pas afatit të transpozimit.

☒ Përderisa praktikat gjyqësore të rastit *Wallonie* i referohen qartë masave legislative, ndoshta duhet të shmangen masat e një natyre më të veçantë (siç janë veprimet hetimore) në periudhën para skadimit të afatit të transpozimit të Direktivës, nëse ato rrezikojnë seriozisht objektivat e kësaj të fundit. Pra, në veçanti, nëse një person do të merret në pyetje, duke bërë kështu në mënyrë të kundërt me Direktivën (p.sh. duke përdorur kompetencat e paligjshme të detyrimit për të nxjerrë pranime të kundërligjshme të fajësisë kundër të drejtës për të mos inkriminuar veten) do të ishte të ndërmerre veprim pozitiv për të kompromentuar drejtësinë e procedurave, në kundërshtim me objektivin e Direktivës për Ndhimë Juridike.

### **Argumente të bazuara në doktrinën e Mangold**

☒ E drejta për prezumim të pafajësisë derisa të dëshmohet e kundërta, është një aspekt i së drejtës për gjykim të drejtë që zakonisht njihet nga të gjitha kushtetutat e Shteteve Anëtare dhe mund të konsiderohet një parim i përgjithshëm i së drejtës së BE-së. Kjo është konfirmuar nga Karta, nga e cila Nenet 47 dhe 48 mbrojnë të drejtën për gjykim të drejtë dhe të drejtat e mbrojtjes. Fakti që Direktiva jep një grup të caktuar të të drejtave për zbatimin e kësaj të fundit nuk e zvogëlon ekzistencën e normës së vetë ligjin primar.

☒ Karta e së drejtës / parimi i përgjithshëm tashmë është në kuadër të së drejtës së BE-së në bazë të Direktivës, dhe megjithëse nuk janë ndërmarrë ende masa specifike për zbatimin e kësaj të fundit, individit mund të mbështetet nga Karta/parimi i përgjithshëm dhe të hedhet poshtë legjislacioni kombëtar i cili është në kundërshtim (në të vërtetë, nëse është në kundërshtim ajo edhe ashtu duhet të ndryshohet në procesin e zbatimit).

### **Referenca e GJDBE?**

☒ Kërkoni një referencë në GJDBE duke kërkuar të dini për efektet e jurisprudencës së rastit *Wallonie dhe Mangold*, në kontekstin e çështjeve penale, në veçanti në lidhje me masën në të cilën një "rezultat" që është në kundërshtim me Direktivën duhet të kuptohet si përfshirje e dënimit dhe zbatimit të dënimeve të bazuara në veprime të papajtueshme me Direktivën, edhe pse këto janë ndërmarrë mbi bazën e masave të zbatueshme para miratimit të legjislacionit që zbaton këtë të fundit.

### **Argumente të bazuara në efektet e KEDNJ-së**

☒ Varësisht nga statusi i KEDNJ-së në juridiksionin tuaj, ju mund të dëshironi të argumentoni se ligjet kombëtare janë në kundërshtim me KEDNJ-në. Direktiva thjesht sqaron, kodifikon dhe i

nënshtrahet detyrimeve të mekanizmave të zbatimit të ligjit të BE-së, që edhe ashtu ekzistojnë në KEDNJ, dhe këto detyrime mund të përdoren si norma të KEDNJ-së në mënyrën e parashikuar nga marrëveshjet kushtetuese kombëtare. Për shembull, nëse ligji kombëtar lejon në përgjithësi zbatimin e supozimeve të pakundërshtueshme të fakteve apo ligjit për vepra penale të caktuara, mund të thuash që - siç sqarohet nga Direktiva - standardet e KEDNJ-së qartë tregojnë se këto supozime duhet të jenë të kundërshtueshme; ato duhet të zbatohen sipas rasteve të veçanta; dhe autoritetet gjithmonë duhet të arrijnë një ekuilibër midis rëndësisë së asaj që është në rrezik dhe të drejtave të mbrojtjes, prandaj gjykatat duhet t'i bashkëngjisin pasojat me mospërputhjen me KEDNJ në përpunje me rregulloret e zbatueshme kushtetuese.

## VII. PËRFUNDIM

101. Ky Manual synon të shërbejë si udhëzues për praktikuesit, organizatat e shoqërisë civile dhe çdo aktërë tjetër kur përfshihen dhe marrin pjesë në procesin e transpozimit të Direktivës përmes reformës legjislativë dhe proceseve gjyqësore vendore. Ai jep një pasqyrë të dispozitave përkatëse të Direktivës dhe një shqyrtim të standardeve relevante ndërkombëtare dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së që duhet të përdoret për të interpretuar Direktivën gjatë fazës para transpozimit. Qëllimi është të ofrojë udhëzime se si mund të përdoret Direktiva gjatë periudhës para transpozimit. Ai inkurajon anëtarët e LEAP dhe rrjetet e tyre për të identifikuar problemet me të drejtën dhe praktikën kombëtare që mund të adresojë Direktiva, me qëllim që të ofrojë një kornizë për zhvillimin e strategjive për të informuar reformën në ligj dhe praktikë në mënyrë që të transpozohet dhe të zbatohet në mënyrë efektive Direktivën.
102. Ky Manual do t'i shpërndahet mijëra avokatëve anëmbanë Evropës, ku të gjithë ftohen që:
- Të na kontaktojnë dhe informojnë se si po ja dalin mbanë me transpozimin e Direktivës në juridiksionet e tyre përkatëse.
  - Të njoftojnë nëse gjykatat nxjerrin vendime pozitive në perspektivën e Direktivës. Këto mund t'i hyjnë në punë njerëzve të vendeve të tjera.
  - Nëse ngritën çështje të interpretimit, merrni në konsideratë rrugën e GJDBE-së: shihni manualin e Përdorimit të së drejtës së BE-së, dokumentin tonë të vitit 2014 për qasjet strategjike të GJDBE-së<sup>130</sup> dhe videon e trajnimit online për procedurën e vendimeve paraprake në praktikën penale.<sup>131</sup>
  - Të vizitoni rregullisht ueb faqen tonë [www.fairtrials.org](http://www.fairtrials.org) për përditësime mbi zhvillimet kryesore lidhur me Direktivat, dhe lajmet rreth trajnimeve personale.
  - Të vini tek ne nëse nuk keni sukses me gjykatat, sepse ne mund të eksplorojmë mundësi të tjera si dërgimin e ankesave tek Komisioni Evropian.
  - Të përfshihen në shtyrjen e çështjeve në kontekstin e brendshëm: shihni dokumentin tonë Drejt një Lëvizjeje të BE-së për të Drejtat e Mbrojtjes<sup>132</sup> për ide konkrete rreth neneve, proceseve gjyqësore, konferencave, etj.

<sup>130</sup>FairTrials, Qasjet strategjike në proceset gjyqësore pranë GJED për Direktivat e Udhërrëfyesit dhe UEA, 2014, në dispozicion në <http://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/140818-CJEU-meeting-report.pdf>.

<sup>131</sup>Në dispozicion në <http://www.fairtrials.org/fair-trials-defenders/legal-training/online-training/>.

<sup>132</sup>LEAP, Strategjitë për Zbatimin Efektiv të Direktivave të Udhërrëfyesit: Drejt një Lëvizjeje të të Drejtave të Mbrojtjes të BE-së, 2015, në dispozicion në <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/5A-IMPLEMENTATION-MOVEMENT-PAPER.pdf>.

